

SHQIPËRI
WIND
CALL YOUR COUNTRY
 TELEFONO NË SHQIPËRI DUKE FILLUAR
 ME NGA 5 QINDARKA NË MINUTË
 INFORMAZIONI WIND.IT

Bota shqiptare

www.shqiptariitalise.com

SHQIPËRI
WIND
CALL YOUR COUNTRY
 TELEFONO NË SHQIPËRI DUKE FILLUAR
 ME NGA 5 QINDARKA NË MINUTË
 INFORMAZIONI WIND.IT

il mondo albanese
 IL GIORNALE DEGLI ALBANESI IN ITALIA
 Quindicinale - Anno XIII - Nr. 268
 16 - 31 ottobre 2011 € 1,50

Iscrizione Registro Stampa del Tribunale di Roma nr. 213/99 del 12.05.99 (cambiamenti in corso). Iscrizione ROC nr 13252. Direttore Responsabile Roland Sejko Stampa: CSQ - Centro Stampa Quotidiani S.p.A Erbusco, BS. Distribuzione nazionale edicole: Messaggerie Internazionali SpA. Tariffa R.O.C.: Poste Italiane s.p.a. - Sped. A.P. - D.L. 353/2003 (L. 46/2004) art.1, c.1,1 - CNS/AC - Roma

ISSN 1720-3678
 0 0 2 6 8
 9 771720367001

Redazione: Via Eleonora Duse 53, 00197 Roma. Tel 06-94354511 Fax 06-97998632. Email: botashqiptare@stranieriitalia.it

BREZAT E DYTË Kryebashkiakët të rinjve: "Mund të bëhesh italian"

Letër atyre që kanë lindur në Itali dhe kanë vetëm një vit kohë për të kërkuar shtetësinë. Nis fushata "18 vjeç ... në Komunë!", edhe me një udhëzues on-line

Plehrat nga Italia Hija e referendumit

Më 22 shtator 2011 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". E vetmja mënyrë për të shpëtuar edhe atë pak Shqipëri që ka ngelur, është referendumi. Mjaftojnë 50 mijë firma të shtetasve me të drejtë vote, për të kërkuar referendum shfuqizues. Të paktën të kemi mundësinë t'i "bëjmë varrin vetes", dhe të mos të lejojmë që varrin të na e bëjnë 69 politikanë

Nga Elton Xhanari, Brescia



SHQIPTARË TË ITALISË

SONILA KACELI
Arti është vetë jeta!

SHQIPTARË TË ITALISË/2



EUGERT ZHUPA
 Çiklisti kampion që
 garon me fanellën kuqezi

Një kompani shqiptare lundrimi mbulon linjën Durrës-Bari



Është themeluar në Durrës kompania e parë shqiptare e lundrimit Albanian Ferries që prej dy javësh ka nisur udhëtimet në linjën Durrës Bari me traqetin e saj Adriatica Queen. Shumë shpejt do të nisë lundrimet edhe Adriatica King

shqiptariitalise.com
 portali i komunitetit shqiptar në Itali

WESTERN UNION | **yes!**

Bota shqiptare

il giornale degli albanesi in italia

testata vincitrice del premio giornalistico M. Souhir

per la multiculturalità nei media come

MIGLIOR GIORNALE PER GLI STRANIERI IN ITALIA

viti XIII i botimit / anno XIII

E përdyjavshme informative-kulturore e shqiptarëve në Itali.

QUINDICINALE DI INFORMAZIONE E CULTURA DEGLI ALBANESE IN ITALIA.

BOTIM I / EDITORE

Keti Biçoku
Via Domenico Ragona 41,
00143 Roma

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës me dekret

TESTATA ISCRITTA AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA n. 213/99 del 12.05.1999

REDAKSIA / REDAZIONE
Via Virgilio Maroso 50,
00142 ROMA

Tel. 06-94354511
Fax 06-97998632
Cell. 393-9712595

www.shqiptariinitalia.com
botashqiptare@stranieriinitalia.it

DREJTOR/DIRETTORE RESPONSABILE
Roland Sejko

REDAKSIA / REDAZIONE
Keti Biçoku, Irida Cami

BASHKËPUNËTORË/ COLLABORATORI
Rando Devole, Giuseppe Chimisso, Albana Temali, Afërdita Shani, Ivan Muccari (grafico)

LEGISLACION EMIGRACIONI
LEGISLAZIONE D'IMMIGRAZIONE A CURA DI
Stranieri in Italia srl, Roma
www.stranieriinitalia.it

REKLAMAT
Tel. 06-94354505
pubblicita@stranieriinitalia.it

SHTYPI / STAMPA
Centro Stampe Quotidiani spa
Via dell'Industria 52,
25030 Erbusco (BS)

Shpërndahet në të gjithë Italinë në pikëshitjet me shtyp në gjuhë të huaj

DISTRIBUZIONE NAZIONALE
NELLE EDICOLE DI STAMPA ESTERA
Messaggerie internazionali SpA
Via A. Manzoni, 8
20089 Rozzano (MI)
Tel. 02-57512612

DORËSHKRIMET NUK KTHEHEN.
ARTIKUJT E PANËNSHKRUAR JANË TË REDAKSISË

Më 8 Shtator 2011 në Bazilikën Santo Stefano në Bolonjë, trupa e Teatrit të Poezisë vuri në skenë "La canzone del Carroccio" të Giovanni Pascoli. Ishte ky kapitulli i tretë i një trilogjie "Le canzoni di Re Enzo", vepër mbi të cilën kjo trupë po punon që në 2008 dhe i referohej një historie të vërtetë që ka ndodhur në Bolonjë në viti 1251 e ku tregohen ndodhitë e Mbretit Enzo, bir i Federikut II, i cili merr lajmin e vdekjes të babait të tij, gjatë burgimit në pallatin e ri të bashkisë.

Kjo shfaqje, për tre net - 8, 9 e 10 shtator - u vu në skenë nga një trupë aktorësh profesionistë, aktorë me eksperiencë por edhe të rinj. Mes tyre ishte edhe një artiste shqiptare Sonila Kaceli, e cila jo vetëm magjepsi publikun me interpretimin e saj si aktore, por edhe si këngëtare me interpretimin e këngëve dhe si kompozitore e muzikës origjinale të pjesës teatrale. Një rol i shumëfishtë ky i artistes shqiptare, që dëshmoi për talentin e saj të shumanshëm, aftësi e formim që nuk lanë indiferentë spektatorët, të cilët mbushnin ambientet brenda kapelave të bazilikës ku spektakli zhvendosej si në kërkim të një të fshehte që nuk mbetet vetëm te fjalët, te interpretimi, por dhe te skenat, që ofronin magjinë e antikitetin e tyre duke i shtuar vlera dhe vetë shfaqjes.

Si bashkatdhetare, dashamirëse e artit, Sonila atë natë më dhuroi emocione të shumta. Pak kush e dinte që ishte shqiptare, por unë për një çast pashë te kjo artiste një trashëgimtare të Aleksandër Moisiut. Ai dikur interpretonte në anglisht... Pas kaq vitesh, Sonila po recitonte e këndonte në italishten e Paskolit në Bolonjë dhe magjepsi publikun. Emocion, krenari për atë që artistët tanë po arrijnë në skenat e huaja por dhe kureshtje për të njohur rrugën e bërë për të arritur deri këtu.

Albana Temali



SONILA KACELI

"Për mua, arti është vetë jeta!"

INTERVISTA

Bota Shqiptare: Sonila si i hytë rrugës së artit? Interpretimi juaj i parë?

Sonila Kaceli: E nisa me një këngë në një aktivitet në të cilin përfaqësoja shkollën "Fan Noli" të Tiranës ku mësoja. Që nga ai moment u bë normale pjesëmarrja në aktivitetet kulturore.

Pastaj u regjistrua në Shtëpinë e pionierit të Lagjes 2 mbasi shkolla ime bënte pjesë te kjo lagje dhe gjithçka shkonte natyrshëm, unë këndoja.. e vazhdoja të këndoja. Kam kënduar edhe në Festivalin kombëtar të Fëmijëve në Shkodër me Pallatin e Pionierëve të Tiranës. Isha 14 vjeç.

Ndërsa formimi artistik?

Ai nisi me konkurrimin për kanto në Liceun Artistik në Tiranë ku fitova dhe atje përfundova diplomimin.

Pastaj erdha në Itali. Këtu për pak kohë kjo rrugë u ndërpre. Normale, mbasi përparësi mori qëndrimi, puna, banimi etj., probleme të qëndrimit në tokën e huaj. Por studimi ishte një ndër objektivat e mi dhe sapo m'u dha mundësia e rimora këtë rrugë. U regjistrua njëkohësisht në Konservatorin e Kozencës dhe në DAMS (Disiplina të Artit, Muzikës dhe Spektaklit) në Bolonjë.

Fotot e këtyre faqeve nga spektakli "La canzone del Carroccio"

Të realizuara nga Marco Frusteri Productions

Viti i parë nuk ishte i lehtë në Bolonjë, por këtij qyteti detyrohem shumë: unë jam formuar këtu si artiste. Lidhjet artistike i kam këtu jo vetëm për sa i përket teatrit por edhe shfaqjeve koncertiste. Këtu kemi dhe një grup trio ballkanike dhe së shpejti nxjerrim dhe ne treg Cd-në e parë



Sonila Kaceli jeton prej gati 20 vjetësh në Itali dhe vjen nga një familje shqiptare me traditë muzikore. Është diplomuar në Universitetin e Bolonjës në Disiplinën Muzikore me një tezë mbi "Veglat muzikore shqiptare". Me "La canzone del Carroccio" të Giovanni Pascolit, Sonila magjepsi publikun me kompozimin e muzikës origjinale të shfaqjes por edhe si këngëtare dhe aktore.

Në dy degë arti njëkohësisht dhe në dy qytete të ndryshme? Sa vështirësi patët për të ndjekur studimet?

Më pëlqenin të dyja degët dhe nuk doja të lija mënjane asnjërën. DAMS nga ana teorike e po kështu kanto. Mbase dhe gabova, se të dyja njëkohësisht kërkonin impajmim por, më vinte edhe keq t'i braktisja. Për këtë arsye, dhe për faktin që ndërkohë punoja koha e studimit u zgjat.

Po transferimi në Bolonjë ndikoi në këtë përzgjedhje?

Siç e thashë, nuk doja të braktisja asnjërën, për këtë u transferova nga Kalabria ku banoja me prindërit e mi në Bolonjë. Kështu studiova DAMS dega muzikë dhe Konservatorin për Kanto po në Bolonjë. Bëra edhe 2 vjet Kompozicion, po në Bolonjë.

Interesa të gjithanshëm do të

thosha... Sa bukur e sa vështirë njëkohësisht.

Po vërtet, më tërhiqnin shumë gjëra bashkë! E kjo gjë ka anën e saj të mirë dhe një tjetër më pak të pëlqyeshme. Për shembull, nuk të lejon të përqendrohesh te njëra prej tyre.

Duke bërë art skenik në Konservator u dashurova dhe me Teatrin. Edhe teatri ka anën e tij të mirë, bile i detyrohem shumë sepse kam qenë një person shumë i ndrojtur e me anën e teatrit arrita ta kaloj. Më ka ndihmuar shumë.

Cila është pjesa e parë me të cilën keni debutuar si aktore?

E nisa pikërisht me një shfaqje që trajtonte probleme sociale dedikuar tre kategorive: të miturve të dënuar me burgime, emigrantëve dhe personave të pastrehë. Kjo ishte eksperiencia ime e

parë me teatrin. Më pas bëra dhe kurse të tjera formimi, të gjitha me teatro eksperimentale ku mund të përmend: Bologna 2000, Living teater, etj.

Ndër më të rëndësishmit ka qenë një kurs dy-vjeçar teatri që bëhej vetëm për gra i organizuar nga ERT (Emilia Romagna Teatro). Me shumë dhimbje u detyrova ta lë këtë shkollë, pasi ndërkohë po bëja edhe tezën e diplomës dhe kjo kërkonte angazhimin tim të plotë. Me shumë, shumë dhimbje e braktisa...

Por fatmirësisht Bolonja si qytet universitar ofron kurse formimi. Arrita të gjej diçka tjetër për të zëvendësuar atë çka humba. Bëra një shkollë private të Teatrit Colli, të drejtuar nga Emanuela Montagna, që ndjek metodën Stanislavskij-Strasberg (si Actors Studio). Kështu realizova ëndrrën time e ndërkohë bëja shfaqje teatri.

Sonila sa ka ndikuar familja në formimin tuaj artistik?

Babi ishte koreograf (shënim i redaksisë: babai i Sonilës është koreografi i mirënjohur Gëzim Kaceli), muzika ka qenë e pranishme në shtëpi. Por edhe mamaja ime, që nuk është marrë me art, na ka ushqyer me këtë dëshirë. Për më tepër, ajo ka një zë shumë të bukur dhe fare mirë mund të ishte marrë me art.

Edhe vëllai ka ndjekur rrugën e artit?

Po. Edhe Renis, im vëlla, ka bërë shkollën e Baletit në Shqipëri (ishte dhe solist i TOB). Në Itali pat ardhur me një bursë studimi në Mantova, më pas u transferua në Kalabri. Vitet e fundit ka ndjekur kursin për mësimdhënie baleti në La Scala dhe e ka përfunduar me diplomë nderi. Sot ka një shkollë baleti

që e drejton bashkë me gruan e tij në Kalabri ku jetojnë.

Studimi në DAMS u kurorëzua me diplomën me rezultatin e shkëlqyer 110/110 duke trajtuar edhe një temë shumë interesante që "thirri" origjinën shqiptare.

Po, e vërtetë, jam diplomuar në DAMS, në degën e Muzikës me një tezë mbi "Veglat muzikore shqiptare". Teza është bazuar mbi përkthimin me nota kritike të një prej veprave më të rëndësishme të organologjisë muzikore shqiptare, "Veglat muzikore të popullit shqiptar" të Ramadan Sokoli dhe Piro Miso.

Më pas kam ndjekur një kurs të formimit të lartë (Master) që e organizonte Universiteti i Bolonjës, më saktë Fakulteti i psikologjisë në bashkëpunim me ATER (Shoqata Shoqata Emilia Romagna Teater) që lidhte artin e kllaunerisë me situatën e personave që vuajnë nëpër spitale.

Ndoqëm shfaqjen e fundit në Bolonjë të organizuar nga Teatri i Poezisë në Bazilikën Santo Stefano ku roli juaj ishte i shumëfishit. Jo vetëm aktore, por edhe kompozitore e këngëve dhe interpretuese e tyre. Ç'paraqesin eksperiencia të tilla për karrierën tuaj?

Shfaqja ishte shumë e rëndësishme për mua, pikërisht sepse mu besuan disa role: isha e vetmja këngëtare por edhe aktore në këtë spektakël e njëkohësisht kisha kompozuar dhe muzikën e këngët mbi bazën e vargjeve të poezisë që Pascoli nuk e ka shkruar për Teatrin, por u vu në skenë dhe kjo më dha mundësi të lidhem akoma më shumë me teatrin edhe nëpërmjet kompozimit. Gjeta frymëzim për t'i bërë vetë këto këngë.

Si e prit kritika?

Nga ana e studiuesve Castoldi (që dhe ka shkruar notat kritike të Re Enzo të Pascolit) kritika ka qenë shumë pozitive. Nuk është e thjeshtë të "muzikosh" Pascolin, dhe mbi të gjitha të mendosh se e ka bërë një shqiptare....

Pas duartrokitjeve të shfaqjes "La Canzone del carroccio" vjen normale pyetja: A do të ketë replika?

Të shpresojmë. Disa nga profesorët e Universitetit, që erdhën dhe në konferencën për shtypin shprehën dëshirën e tyre që shfaqja të rivihet në skenë, meqenëse vitin që vjen është 100 vjetori i vdekjes së Pascolit, dhe në Bolonjë, në muajin shkurt do zhvillohet një Konferencë për figurën e Pascolit.

Çfarë përfaqëson Bolonja për ju Sonila? A mbani lidhje me Shqipërinë, qoftë dhe nëpërmjet aktiviteteve me artistë apo me shoqatat shqiptare që veprojnë në teritor?



”

Shfaqja ishte shumë e rëndësishme për mua, sepse mu besuan disa role: isha këngëtare dhe aktore, por kisha kompozuar muzikën e këngët mbi bazën e vargjeve të poezisë që Pascoli nuk e ka shkruar për Teatrin. Vënia në skenë më dha mundësi të lidhem akoma më shumë me teatrin edhe nëpërmjet kompozimit

EUGERT ZHUPA

Çiklisti kampion që garon me fanellën kuqezi

21-vjeçari, në Itali nga 1996 garon që kur ishte 13 vjeç duke koleksionuar fitore pas fitoresh. Ende nuk ka marrë shtetësinë italiane, por ndërkaq fiton garën kushtuar 150 vjetorit të Unitetit të Italisë

Në garë për skuadrën Trevigiani, por me fanellën e kuqe me shqiponjën e zezë në gjoks, sot çiklisti Eugert Zhupa ka fituar garën e pestë për këtë sezon. Ai ka dalë i pari mes 134 çiklistëve që kanë marrë pjesë në garën e organizuar nga Gs Parmense për 150 vjetorin e Unitetit të Italisë.

Zhupa është 21 vjeç, prej pesëmbëdhjetë vjetëve jeton në Itali, sot është rezident në Scandiano të Reggio Emilias. Ai ka nisur të garojë në çiklizëm që 13 vjeç me Ciclistica 2000 të Rubiera-s duke fituar 4 gara, më pas ka veshur fanellën e Nial Nizzoli të Correggio-s duke fituar 7 gara, ndërsa sot është në radhët Unione Ciclistica Trevigiani në kategorinë e amatorëve nën 23 vjeç. Për këtë sezon ka fituar 5 gara, përveç të sotmes, edhe në Mareno, San Vendemiano, një në rrugë e një në pistë në Shqipëri.

Fitoret e deritanishme dhe mosha e tij e re mund t'i hapin shpejt dyert e antagonizmit në çiklizëm, që është edhe objektivi që ai i ka vënë vetes për këtë vit.

Djali që vrapon me fanellë kuqezi, që në skuadër e thërrasin "shqiponja e Shqipërisë", pas 15 vjetëve në Itali, brenda pak ditëve do të marrë pasaportën italiane, dhe fitorja në garën kushtuar 150 vjetorit të Unitetit të Italisë, duket një urim i mirë për të. *ke.bi.*



SONILA KACELI

Arti është vetë jeta!

vijon nga faqja 3



Viti i parë nuk ishte i lehtë në Bolonjë, por këtij qyteti detyrohem shumë: unë jam formuar këtu si artiste. Të gjitha lidhjet artistike i kam këtu jo vetëm përsa i përket teatrit por edhe shfaqjeve koncertiste. Këtu kemi dhe një grup trio ballkanike dhe së shpejti nxjerrim dhe ne treg Cd-në e parë. Ndërsa me shoqatat kam vetëm lidhje të rastësishme, sidomos nëpërmjet kësaj trio mbasi bëjmë muzikë ballkanike por dhe shqiptare.

Cila është aspirata juaj me këtë bagazh formimi të shumanshëm?

Dëshira ime është mbi të gjitha të vazhdoj në fushën e artit. Për mua muzika e teatri janë jeta vetë.

Projekte të reja së afërmi?

Një koncert në Bentivoglio me trio ballkanike. Promovimi i Cd-së me këngët e kësaj trioje. Një spektakël me Teatrin e poezisë në nëntor. E të tjera e të tjera.

Kujt ia dedikoni arritjet e tuaja?

Familjes sime, babit mbi të gjitha, mamit e vëllait. Personat e tjerë që më kanë ndihmuar kanë qenë shumë e nuk mund të veçoj asnjërin prej tyre mbasi u jam mirënjohëse të gjithëve. Arritjet e mia ia dedikoj Artit e Familjes time.

Albana Temali, Bolonjë

Il fotografo Dritan Mardodaj, a Roma con "Ordine e Caos"

La fotografia come mezzo di espressione prediletto per rappresentare la complessità dell'animo umano e del mondo: questa è in poche parole l'arte di Dritan Mardodaj, giovane fotografo albanese da anni in Italia, in mostra per la prima a Roma, presso l'Associazione Culturale DEFRAG.

Dopo le prime sperimentazioni artistiche con disegno e pittura, Dritan Mardodaj capisce che è la fotografia il miglior modo per esprimere il suo animo: cosa se non l'occhio di una macchina a fotogrammi reiterati può documentare tutte le sfaccettature di una società troppo spesso corrotta e lasciata a se stessa?

In questa ricerca artistica di sé e del mondo, si inserisce la serie "Ordine &

Caos", nata dall'esigenza del giovane fotografo di differenziare l'ordine dal caos, l'inquietudine dalla felicità, ma soprattutto dalla necessità di mettere in luce questo eterno binomio che da sempre tormenta l'animo umano.

Nelle foto di Dritan Mardodaj tutto è fortemente simbolico e metaforico: in un mondo generato da violenza, odio e mancanza di libertà, l'artista mostra immagini geometriche e lineari che sembrano ricercare il controllo di un ordine superiore il quale, però, va a scontrarsi con un intimo pessimismo di fondo: con quest'ordine superiore, che sia umano o divino, tutti gli esseri sono destinati a soffrire in silenzio.

Nelle sue foto, Dritan omette volu-

tamente l'essere umano, da sempre corrotto e pieno di vizi, prediligendo oggetti e soggetti innocenti e allegorici che, talvolta, lasciano intravedere una vaga speranza: forse non tutto è perduto e una flebile luce squarcia il velo di pessimismo tipico dell'artista che, timidamente, si apre all'amore e alla fiducia.

Dritan Mardodaj nasce a Tirana in Albania nel 1983, dove trascorre l'infanzia e la prima giovinezza fino al 2003, anno in cui arriva in Italia; affascinando dalla cultura artistica del Bel Paese, si iscrive alla Facoltà di Lettere di Parma, dove si laurea in Beni Culturali.



Ordine & Caos - mostra fotografica di Dritan Mardodaj

Inaugurazione: sabato 22 ottobre 2011, ore 21.30

Aperta al pubblico: dal 22 al 28 ottobre 2011; mar-merc-ven-sab-dom. dalle ore 16.30 alle 02.00 - lun-giov. dalle ore 16.30 alle 21.00

Presso DEFRAG - Associazione Culturale e di Promozione Sociale - Via delle Isole Curzolane, 75 - Roma

Info: www.associazionedefrag.net - info@associazionedefrag.net - Tel. 320.0486439



PO MAMI SI ËSHTË?

E Endri? E Mirushi?

E Rezarti? E Bardhyli? E Artani?

E Drita? E Merita? E Floriani? E Iliri?

E Kamila? E Rezarta? E Anila? E Blerina? E Darina?

**CALL YOUR COUNTRY
DHE SUPER NOI WIND.
PËR TË NDIER TË GJITHË BOTËN MË PRANË.**

CALL YOUR COUNTRY. FLET ME **SHQIPËRINË** EDHE ME **5 QINDARKA** NË MINUTË.
DHE ME **SUPER NOI WIND** ÇDO JAVË, ME VETËM 3€, KE 400 MINUTA DHE 400 MESAZHE ME TË GJITHË MIQTË E TU WIND.



AKTIVIZO CALL YOUR COUNTRY
ME NJË SMS FALAS
DUKE INKUADRUAR KODIN
ME SMARTPHONE-N TËND



AKTIVIZO SUPER NOI WIND
ME NJË SMS FALAS
DUKE INKUADRUAR KODIN
ME SMARTPHONE-N TËND

PËR MË SHUMË INFORMACIONE MBI KOSTOT, KUSHTET DHE KUFIZIMET, SHKO NË WIND.IT

Call Your Country. Kosto për minutë me Shqipërinë: **5 qindarka me numrat e rrjetit fiks, 10 qindarka me celularët.**
Kosto semestrare 4 euro Falas në promovim kostoja semestrare për 6 muajt e parë. Kosto e aktivizimit 7 euro, falas për klientët e rinj deri më 13/11/2011. Shkrehje në përgjigje 16 cent. Tarifimi çdo 60 sekonda. Super Noi Wind: pa kosto aktivizimi për të gjithë klientët.


WIND
Più vicini.



A I KE SHTATË
LIQENET E LURËS
NË KOPËSHT?



SIGNORINA,
UNA
SCHEDINA!

MUND
TË FITOSH
JACKPOTIN
MILIONER.



SuperEnalotto 

ËNDRIMTAR LIND,
MILIONER BËHESH.



Nëse nuk ke mbushur 18 vjeç, nuk mund të luash.

Kërkojmë që të caktohet një deputet zone për Italinë, siç e kanë të gjitha degët e tjera të PS-së në Shqipëri". Kjo është një nga kërkesat që duket se dega e PS-së në Itali do t'i dërgojë Kongresit të Partisë socialiste që do të mbahet në Tiranë më 5 nëntor.

Edmond Kumaraku, kryekoordinator i degëve të PS-së në Itali tregon për shqiptaritalise.com se tashmë në Itali janë ngritur mbi 65 degë në qytete të ndryshme, dhe se në 22 tetor (në Rimini, rruga XXIII settembre 124/C në orën 10.00) do të mbajnë asamblenë III të përgjithshme ku do të shqyrtojnë edhe kërkesat që vijnë nga degët e qyteteve. "Duam t'i paraqesim kongresit të PS-së, kërkesat tona, që kanë si qëllim dhënien e një peshe më të madhe në vendimmarrje të shqiptarëve që jetojnë në Itali. Kërkesat do të kristalizohen në Asamblenë e 22 tetorit, tani jemi duke i mbledhur ato nga degët e ndryshme në Itali".

Nga sa duket, kërkesat më të mundshme që do t'i nënshtrohen për votim asamblesë për t'iu paraqitur partisë kanë të bëjnë me të drejtën efektive të votës së emigrantëve përmes postës (dhe jo në struktura si konsullata e ambasada apo elektronikës), përfaqësim më të lartë të emigrantëve shqiptarë në Itali në Forumet drejtuese të partisë, e drejta për anëtarët e asamblesë së përgjithshme të degëve të PS-së në Itali, të jenë anëtarë edhe në asamblenë të degëve të PS-së në qytetet përkatëse shqiptare nga janë këta emigrantë, vetëvendosjen e asambleve të degëve të Italisë në zgjedhjen e koordinatorëve dhe të kryekoordinatorit, ndryshimit të emërimit të tyre nga "koordinatore" në "Kryetarë", si dhe përfaqësimin me një deputet të emigrantëve socialistë në Itali.

"Jemi në Itali mbi 500 mijë shqiptarë, pse të mos kemi zë në vendimmarrjen, qoftë të partive ku jemi të aktivizuar, qoftë në parlament" thotë Kumaraku.

Si mund të zgjidhet një deputet nga emigracioni? "E thjeshtë. Nëse na jepet e

Edhe një EMIGRANT nga Italia, deputet në KUVENDIN E SHQIPËRISË

Dega e PS-së në Itali do t'i nisë kërkesat e veta Kongresit të partisë. Mes tyre, edhe kërkesa për një vend në Kuvend



drejta e votës me anë të postës, komuniteti këtu mund të propozojë kandidatët të zgjedhur mes emigrantëve e më pas t'i votojë. Nëse nuk arrihet të votojmë në Itali, përmes kërkesës që i bëjmë partisë për t'u dhënë të drejtë anëtarëve të asamblesë së degës PS në Itali të jenë anëtarë edhe të asambleve

të degëve të PS-së në qytetet përkatëse shqiptare nga janë këta emigrantë, duam të kemi zë në zonat zgjedhore në Shqipëri. Dhe në zonat me emigracion të fortë, pse jo, të çojmë në Kuvend një socialist që të përfaqësojë emigracionin".

"Të gjitha kërkesat tona, të

“ Në Itali mbi 500 mijë shqiptarë, pse të mos kemi zë në vendimmarrjen?

Qoftë të partive ku jemi të aktivizuar, qoftë në parlament.

mësipërmet e të tjera, që do të votohen përfundimisht më 22 tetor, do t'ia çojmë Kongresit të Partisë Socialiste në të cilin, si degë e Italisë, kemi 6 delegatë permanentë me të drejtë vote dhe 15 të ftuar" përfundon Kumaraku.

Keti Biçoku

ZYRË SHËRBIMESH, KONSULENCE DHE PËRKTHIMESH

Përkthime të Autorizuara me Apostille nga Italia ose Shqipëria të Certifikatave të Lindjes për regjistrimin e fëmijëve në Zyrat e Gjendjes Civile në Shqipëri, të Certifikatave Familjare, Martesore, Penale për shtetësinë italiane, Përkthime Prokurash Speciale, Diplomash, Konvertime Patentash, Certifikata për lidhje martesore, Informacione nga interneti mbi pasaportat biometrike, Viza pranë Ambasadave të ndryshme, etj. Dokumentet nisen me postë dhe brenda pak ditësh Ju arrijnë në adresën që dëshironi.

Cell. 327.8848348

VLORË, BERAT e GJIROKASTËR

Java e gjuhës italiane në botë, më 21-26 tetor

Aktivitetet për promovimin e vlerave të kulturës dhe të gjuhës italiane do të organizohen në këto qytete, në kuadrin e Javës së Njëmbëdhjetë e Gjuhës Italiane në Botë, të organizuar nga Konsullata e përgjithshme e Vlorës dhe nga Instituti italian i kulturës

Në datat 21-26 tetor, në Vlorë, Berat dhe Gjirokastrë, do të zhvillohet Java e Njëmbëdhjetë e Gjuhës Italiane në Botë, e organizuar nga Ministria e Jashtme e Italisë, përmes Konsullatës së Përgjithshme në Vlorë dhe Institutit Italian të Kulturës në Tiranë.

Kjo javë, që e ka zanafillën e saj në vitin 2001, e ideuar nga Ministria e Jashtme e Italisë dhe Akademia e Crusca-s, nën kujdesin e Presidentit të Republikës Italiane, ka si synim promovimin e kulturës dhe të gjuhës italiane në të gjithë botën. Gjatë viteve, aktivitetet e organizuara me këtë rast kanë ardhur duke u rritur në numër e cilësi.

Burime zyrtare të Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë, bëjnë të ditur se, gjatë ditëve të Javës së Gjuhës Italiane në rajonin që mbulon kjo konsullatë, që përfshin mes të tjerash edhe rrethet Berat e Gjirokastrë, veç Vlorës, do të organizohen aktivitetet me të rinjtë e shkollave

“ Do të organizohen aktivitetet me të rinj ku do të promovohen vlera të kulturës dhe të gjuhës italiane, do të jepen koncerte nga artistë italianë, do të prezantohen libra nga autorë të njohur të vendit fqinj, do të ketë gjithashtu shfaqje kinematografike. Një aktivitet i veçantë do të jetë ai që do të zhvillohet në një nga lokalet e njohura në qytetin e Vlorës, ku do të jepen mësimet nga kuzhina italiane

të mesme dhe studentë, ku do të promovohen vlera të kulturës dhe të gjuhës italiane, do të jepen koncerte nga artistë italianë, do të prezantohen

libra nga autorë të njohur të vendit fqinj, do të ketë gjithashtu shfaqje kinematografike. Një aktivitet i veçantë do të jetë ai që do të zhvillohet në një nga lokalet e njohura në qytetin e Vlorës, ku do të jepen mësimet teorike dhe praktike nga kuzhina italiane.

Për herë të parë aktivitetet në kuadrin e kësaj jave, në rajonin e jugut të vendit u zhvilluan në muajin tetor të vitit 2009, kur tema e Javës së Gjuhës Italiane në Botë, ishte "Gjuha italiane mes artit, shkencës e teknologjisë". Gjatë katër ditëve u organizuan konferenca për arkitekturën italiane në Shqipëri, mbi mbrojtjen e pasurisë artistiko-kulturore shqiptare dhe mbi artin prehistorik në jug të vendit. Gjithashtu u shfaqën filma për shkencëtarë italianë, projekte, një ekspozitë me makineritë e ideuara nga Leonardo Da Vinçi. Në qytetet e Vlorës dhe të Gjirokastrës u shfaq edhe një film dokumentar kushtuar Guglielmo Marconit, shpikësi i radios, ose siç quhet ndryshe, "Babai i telekomunikacionit modern".

TIM CARD ALBANIA LIMITED EDITION.

Me **6** cent/min flet me të gjithë
numrat në Itali dhe numrat
fiks në Shqipëri.



Dhe flet me celularët në Shqipëri vetëm me 9 cent/min.
Kalo në TIM dhe dyfisho rimbushjet për 2 vjet.
Deri në një maksimum prej 50€/muaj.

IMPULS NË PËRGGJIGJE 16 CENT DHE TARIFIM ME IMPULSE PREJ 30 SEKONDAËSH

TELEFONO NË 119, QË SOT EDHE NË GJUHËN TËNOE, DSE HYR NË DYQANET TIM.

Tarifat promovionale për thirrjet drejt Shqipërisë janë të vlefshme deri në 3000 min. çdo 30 ditë. Oferta promovionale për thirrjet drejt operatorëve të bashkëpunuesve për një maksimum prej 200 minutash në javë. Për informacione rreth kostove pasi të kthehesh ky limit hyr në www.tim.it. Oferta promovionale "dyfishimi i rimbushjeve" është e vlefshme për ata që kalojnë në TIM duke mbajtur numrin e tyre brenda datës 4/12/2011. Duke filluar nga muaji 1/2, për të përfituar nga promovioni, është e nevojshme të rimbushni kartën me të paktën 20€ çdo 30 ditë.



Troppo "albanese" per restare, troppo "italiano" per tornare

Mi chiamo... anzi no, non mi piace specificare. Diciamo che l'uniche cose che vorrei sappiate di me sono due: Ho 28 anni, e sono 7 anni fuoricorso.

Sì, sono d'accordo, l'università non è cosa da poco, ma a quanto pare non è nemmeno cosa da tutti! Quando accetteremo questo dato di fatto?

Il mio primo anno! Anzi, il mio primo giorno da sbarcato o atterrato in Italia. Primo giorno da studente universitario. Ero disorientato dal nuovo ambiente, ed ero ubriaco fradicio dal "io studio in Italia", dal fascino da "tornato per le vacanze in Albania", le cose nuove da raccontare agli amici, dal nuovo stile di vita, senza i genitori per chi più e per chi meno assillanti, che mi sono dimenticato del vero motivo, (o dovrei dire scusa) che mi stavo rovinando in questo paese straniero... qual'era? Ah sì: LO STUDIO. Mannaggia sì!

-Adesso vado a "leggere un pò"!

Che cavolo significa "leggere un pò"? quando in tanto devi "studiare tanto".

Poi eccola: la sezione degli esami. Se superi il tuo primo esame in assoluto, ti senti un dio, oppure se il tuo ego non è così megalomane...dopo questo esame cominci a credere in dio. La vera tragedia è quando non riesci a superarlo. E' lì che cominciano i guai. All'inizio ci sono i sensi di colpa:

Sette anni fuoricorso

Riceviamo e volentieri pubblichiamo l'editoriale dell'ultimo numero della rivista ORA realizzato dall'ASUF (Albanian Students of the University of Florence)



La vera domanda è: ci crediamo noi capaci di cominciare una vita piena di responsabilità dopo solo 5 anni di "vita da studente"? E quanti di noi hanno profondamente odiato la domanda: Quando finisci l'università (e qua c'è la parentesi nella tua testa: se la finisco!) hai intenzione di tornare o di restare?

potevo studiare di più, dovevo uscire di meno. Sensi più che giustificabili ma che piano-piano la nostra "parte buona" comincia a giustificarsi: sono al primo anno, ci sono le difficoltà della lingua, non ho ancora un buon metodo di studio...

Ed è questa "parte buona" che mi ha fregato. Quando invece dovrebbe essere questa "scusa" la ragione o il motivo per cui io (studente atterrato in un paese straniero) dovevo impegnarmi il doppio con lo studio.

Poi c'è quello che io chiamo "effetto domino". Un esame "sposta" l'altro. Esami che si spostano da un appello a quello successivo, diminuendo così il numero degli esami programmati. Ogni esame non preparato o non superato ci spinge verso la cosiddetta crisi del "devo trovare un lavoro".

Una volta trovato lavoro le ore intenzionate allo studio si diminuiscono, sciogliendosi come i granuli di zucchero nelle tante tazze di caffè che comincio a prendere. Sappiamo benissimo tutti che le ore "intenzionate" allo studio sono inversamente proporzionali al numero degli amici o conoscenti che si trovano nelle stesse aule studio. Un saluto dopo l'altro, una pausa dopo l'altra, una sigaretta dopo l'altra, un giorno dopo l'altro, un anno dopo l'altro, un esame dopo l'altro ci troviamo a fare una vita da "fuori corso". E la vita da fuori corso è la prova che il tempo si è fermato...

Una mia idea personale è

che per noi studenti stranieri che studiamo in Italia il tempo scorre diversamente. Percepriamo un altro concetto del tempo, diverso da quello che trascorriamo nella nostra patria. Una volta toccata la terra straniera il tempo rallenta. Viviamo in un'altra dimensione spazio-temporale e ci mettiamo comodi (popcorn inclusi) a guardare questo strano film chiamato "Vita" oppure più precisamente "Vita da studente".

Tutto scorre lentamente, senza cambiamenti professionali, sempre parlando della professione che si presuppone uno ambisca avere dopo gli studi, perché intanto di professioni ne hai cambiate tante: dal cameriere al pizzaiolo, dal receptionista al barista...

La vera domanda è: ci crediamo noi capaci di cominciare una vita piena di responsabilità dopo solo 5 anni di "vita da studente"? E quanti di noi hanno profondamente odiato la domanda: -Quando finisci l'università (e qua c'è la parentesi nella tua testa: se la finisco!) hai intenzione di tornare o di restare?

Siamo troppo "albanesi" per restare in Italia e siamo (pur)troppo "italiani" per tornare in Albania. Ormai abbiamo la vita sdoppiata: albanesi in Italia e "italiani" in Albania. Porca miseria! Viviamo due vite parallele e in tutte e due i casi siamo "étrangère"!!!

Ofertë pune

Sipërmarrja e ndërtimit

Ella Immobiliare s.r.l., me seli në Romë, kërkon një vajzë shqiptare për punësim me kohë të plotë si sekretare. Kërkohen njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit, të gjuhës italiane dhe seriozitet në punë. Kush është e interesuar, mund të kontaktojë Sokolin në Cell. 327.4403506

1.500 euro për tezën më të mirë mbi miqësinë Itali-Shqipëri

Shoqatat Ilirianët, Ambito Sociale dhe Universiteti i Urbinos hapin një konkurs për tezën e diplomimit më të mirë mbi marrëdhëniet Shqipëri-Itali. 1.500 euro fituesit

Konkursi "Miqësia Itali-Shqipëri nga viti 1500 e këtej" do të vlerësojë me 1.500 euro tezën e diplomimit më të mirë mbi marrëdhëniet kulturore Itali Shqipëri. Organizohet nga shoqata e shqiptarëve "Ilirianët" dhe "Ambito Sociale", Universiteti i Studimeve "Carlo Bo" të Urbinos dhe me mbështetjen e komunës së Fanos.

Është i hapur për të gjithë studentët e diplomuar në Universitetin e Urbinos, që kanë pasur si tezë të diplomimit të tyre një temë mbi marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Italisë. Të interesuarit duhet të dorëzojnë tezën e tyre, një kopje në letër dhe një tjetër në format digjital, brenda 15 nëntorit 2011, pranë zyrës 'Erasmus e Relazioni Internazionali' (via Saffi, 1 -61029 Urbino). Fituesi do të përzgjidhet nga një juri e përbërë nga tre profesorë të universitetit të Urbinos, nga koordinatoresha e Ambito, Sonia Battistini dhe kryetari i shoqatës Ilirianët Novruz Kareci. Shoqata Ilirianët është themeluar

“Është i hapur për të gjithë studentët e diplomuar në

Universitetin e Urbinos, që kanë pasur si tezë të diplomimit të tyre një temë mbi marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Italisë. Të interesuarit duhet të dorëzojnë tezën, një kopje në letër dhe një tjetër në format digjital, brenda 15 nëntorit 2011, pranë zyrës 'Erasmus e Relazioni Internazionali' (via Saffi, 1 -61029, Urbino)

në vitin 2001 dhe në këto dhjetë vjet ka zhvilluar veprimtari të larmishme

dhe ka çuar përpara projekte të ndryshme mbi integrimin e shqiptarëve në territorin e Urbinos. Herë vetëm e shpesh në bashkëpunim me shoqata të tjera apo me ente lokale. "Veprimtaria e shoqatës sonë është e pasur - tregon për Shqiptariitalise.com, kryetari i shoqatës, Kareci - dhe e kam të vështirë t-i numëroj. Mund të kujtoj, për shembull, veprimtaritë e zhvilluara për festën e pavarësisë, prezantimin e kuzhinës shqiptare miqve italianë, ngritjen e "bibliotekës multietnike" në bashkëpunim me shoqatën Millevoçi, projektin "Io racconto, tu racconti noi ascoltiamo" edhe këtë në bashkëpunim me shoqata të tjera e entet lokale". Por shoqata nuk është ndalur këtu. "Kemi ndihmuar konkretisht shqiptarë në nevojë në marrëdhëniet e tyre me administratën publike italiane, për marrjen e dokumenteve, për shembull" shpjegon gjithnjë Kareci. Projekti i ardhshëm? "Ndoshta arrijmë të realizojmë binjakëzimin mes Sarandës dhe Fanos" thotë Kareci.

Në GENOVA, imigrantët nuk mund të ngasin urbanët

Ndërmarrja për Lëvizjen dhe Transportet e Bashkisë ka futur "Shtetësia italiane ose e BE-së" mes kriterëve për rekrutimin e shoferëve. ASGI paraqet ankimmim: "Është diskriminim"

Zotësi si shofer, dhunti përqendrimi, durim, përpikëri, mirësjellje me pasagjerët. Janë tashmë të shumta aftësitë e shoferit të përkryer të autobusëve urbanë, por Ndërmarrja për Lëvizjen dhe Transportet (ATM) e Genovas ka shtuar edhe një kriter: të mos jesh jokomunitar.

Gushtin shkuar kanë nisur përzgjedhjet për rekrutimin e shoferëve. "Po kërkojmë kandidatë të motivuar për të kryer një profesion me rëndësi në shërbim të qytetit. Ndërmarrja jonë është historike, dinamike dhe novatore, e aftë t'i bëjë ballë ndryshimit, një pikë referimi për gjenovezët" lexohet në faqet internet të ATM të qytetit.

"Eja bëj pjesë edhe ti në skuadrën tonë!" lexohet pak më poshtë. Por, duke mos marrë parasysh "ndryshimin" që ka pësuar Genova duke u bërë një qytet me imigracion të fortë, lë jashtë lojë të gjithë imigrantët. Për të paraqitur kërkesë si shofer i autobusëve urbanë të Genovas duhet të kesh patjetër "shtetësi italiane ose të BE-së", dhe në rastin e dytë të dëshmosh një njohje të përshtatshme të gjuhës italiane.

E përse përjashtohen jokomunitarët? Shoqata për

Kriteri i shtetësisë italiane ose i një vendi të BE-së "është jo vetëm i paligjshëm sepse shkel normat e tekstit unik mbi imigracionin dhe të Konventës Oil të vitit 1975, por është edhe diskriminuese".

Ekziston një rast i ngjashëm i mëparshëm. Edhe në Milano, ATM nuk punësonte të huaj jokomunitarë, duke u bazuar në një dekret mbretëror të vitit 1931 që parashikonte shtetësinë italiane për makinistët e autobusëve, trenave dhe tramvajit.

fikojnë e të deklarojnë karakterin diskriminues të qëndrimit të mbajtur nga ndërmarrja e transporteve duke kërkuar kështu eliminimin shtetësinë nga kriteret e punësimit.

Ekziston një rast i ngjashëm i mëparshëm. Edhe në Milano, ATM nuk punësonte të huaj jokomunitarë, duke u bazuar në një dekret mbretëror të vitit 1931 që parashikonte shtetësinë italiane për makinistët e autobusëve, trenave dhe tramvajit. Në vitin 2009 gjykata e konsideroi "të abroguar në heshtje" atë normë sepse teksti unik mbi imigracionin "u garantonte të gjithë punonjësit të huaj me qëndrim të rregullt trajtim të njëjtë e barazi të plotë të drejtash me punonjësit italianë".

Elvio Pasca

BREZAT E DYTË

Kryetarët e komunave do t'u shkruajnë të rinjve: "Tani mund të bëhesh italian"

Një letër atyre që kanë lindur në Itali dhe kanë vetëm një vit kohë për të kërkuar shtetësinë. Nis fushata "18 vjeç ... në Komunë!", edhe me një udhëzues on-line

Janë rreth 15 mijë të rinjtë e të rejtat me moshë nga shtatëmbëdhjetë në tetëmbëdhjetë vjeç, të lindur në Itali me prindër të huaj të cilëve do t'u drejtohet vitin e ardhshëm fushata "18 vjeç ... në Komunë!" e shpallur në Romë më 13 tetor nga ANCI, Save the Children dhe Rrjeti G2-Brezat e Dytë.

Objektivi është sensibilizimi i sa më shumë kryetarëve të komunave që të informojnë në kohë brezat e dytë - pra të miturit e lindur në Itali nga prindër të huaj - mbi mënyrën e marrjes së shtetësisë mbe mbushjen e moshës madhore. Iniciativë e nisur tashmë në disa komuna, si për shembull, prej disa javësh

në Milano.

Sipas normativës aktuale, bijtë e imigrantëve mund të bëhen italianë nëse kanë lindur këtu dhe, përveçse janë regjistruar në zyrën e Gjendjes Civile, kanë pasur rezidencën legale në Itali deri në mbushje e 18 vjeçëve pa ndërprerje. Për të marrë shtetësinë duhet të paraqesin kërkesë në Komunë të rezidencës para se të mbushin 19 vjeç. Problemi qëndron në faktin që një pjesë e mirë e tyre nuk e dinë që për të paraqitur kërkesën kanë vetëm një vit kohë duke filluar nga çasti kur mbushin 18 vjeç.

Nga kjo merr shkas ideja që Komunat t'u nisin një letër të rinjve me origjinë të huaj të lindur në Itali që po mbushin

moshën madhore, për t'i informuar ata mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtës së tyre për t'u bërë qytetarë italianë. Rrjeti G2 ka është përkujdesur edhe për një udhëzues të botuar online me titull "18 anni... in Comune!", që shpjegon procedurën dhe të mirat e përdorimit të këtij kanali për të marrë shtetësinë.

Janë shifrat ato që demonstronjën rëndësinë e kësaj iniciative, mbi të gjitha për të qenë largpamës. Në vitin 2010, sipas ISTAT-it, kanë lindur rreth 78 mijë fëmijë të huajish, 13,9% e të gjithë të lindurve rezidentë në Itali, me një rritje prej 1,3% krahasuar me një vit më parë.

Tashmë 10 mijë firma për shtetësinë dhe të drejtën e votës

Nis mirë mbledhja e firmave për dy propozimet e ligjeve me iniciativë popullore të fushatës "Italia jam edhe Unë". Miraglia (Arci): "Janë tema që u interesojnë qytetarëve, flasim për të ardhmen e Italisë"

Tandërojnë normat mbi shtetësinë italiane duke ua njohur menjëherë brezave të dytë dhe t'u japë të drejtën e votës imigrantëve për zgjedhjet lokale. Dy pikësynimet e fushatës "Italia jam edhe unë" (l'Italia sono anch'io) duken ende larg, por ndërkohë, fundjavën e shkuar hedhur një hap përpara. Janë tashmë dhjetë mijë firmat e mbledhura në mbarë Italinë për secilin propozim ligji me iniciativë popullore të promovuara nga rreth 20 shoqata. Por mungojnë akoma 40 mijë, që duhen siguruar deri në fund të shkurtit, më pas mund të shkohet e të trokitet në parlament.

"Deri më sot, rezultati është i shkëlqyer. Njerëzit janë të interesuar, ndalen, informohen, diskutojnë dhe firmosin. Për ne konfirmim që është e mirë idea e inicia-

tivës sonë: përfshirja e territorit, e të gjithë qytetarëve, diskutimi pozitiv mbi imigracionin, larg temave të frikës dhe pasigurisë të përdorura nga një pjesë e politikës" thotë për Stranieriinitalia.it Filippo Miraglia, përgjegjës për imigracionin i Arci-t.

"Vitin e shkuar - shton ai - kanë lindur në Itali 78 mijë fëmijë që duhet të presin 18 vjet për t'u bërë italianë. Pyetja se cila duhet të jetë e ardhmja e tyre, pra e ardhmja e gjithë vendit tonë, na intereson njerëzve. Duhet t'i interesojë edhe politikës".

E drejta e votës për imigrantët dhe reforma e shtetësisë nuk janë tema të reja për parlamentin italian. Projekt ligjet e paraqitura deri më sot mbeten gjithnjë në fund të sirtarëve. Pse këto të fushatës popullore duhet të kenë një tjetër fat?

"Sepse vijnë nga poshtë dhe politika nuk mund t'i shmangë" përgjigjet Miraglia. "Të tonat janë propozime të thjeshta e të qarta ndaj të cilave është e lehtë të mbash ëqndrim. Janë si një referendum mbi një ide të qeverisjes së imigracionit që ka të bëjë vërtet me të ardhmen. Një debat publik, nga i cili politika nuk mund të tërhiqet".

Ndërkaq, mbledhja e firmave vazhdon. Fundjavën e shkuar ishin hapur rreth 30 komitete lokale, dhe po ngrihen të tjera në të gjitha krahinat e qytetet, nga Trentino deri në Sicili, nga Friuli deri në Sardenjë. "Shumë shpejt do t'i dyfishojmë komitetet. Nuk dua ta teproj, por nëse vazhdojmë me ritmet e tanishme do të kapërcejmë bollshëm 50 mijë firmat nën dy propozimet tona".

Elvio Pasca



„ Është e rëndësishme që brezat e dytë të lindur në Itali të ushtrorjnë të drejtën e tyre të zgjedhjes sipas nenit 4 të ligjit 91 të vitit 1992. Ky nen bazohet në parimin e ius soli, parim themelor që duhet të frymëzojë reformën e këtij ligji. Jemi plotësisht të bindur se tashmë është koha që Italia të jetë Vendi i të gjithë bijve të saj pa asnjë diskriminim

G2: "Italia të jetë Vendi i të gjithë bijve të saj"

"Marrja e shtetësisë, e bashkë me të, e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve, përbën një etapë të rëndësishme në rrugën drejt integritit të plotë" thotë Graziano Delrio, kryetar i komunës së Reggio Emiliat dhe president i ANCI-t (shoqata kombëtare e komunave italiane). "Kjo - shton ai - vlen veçanërisht për të rinjtë e lindur e të rritur në Itali, bashkëqytetarë tanët faktikisht por jo ligjrisht. Për këtë arsye, si shoqatë ANCI, kemi përkrahur me bindje këtë fushatë informimi, në gjurmët e

Bashkia e Milanos u shkruan 18-vjeçarëve: "Mund të bëhesh italian"

Një letër e administratës vendore u kujton bijve të imigrantëve të lindur në Itali që mbushin moshën madhore se mund të kërkojnë shtetësinë italiane. Drejtori i politikave shoqërore, Majorino: "Pakush e njeh këtë mundësi që i jep ligji"

"Mbush 18 vjeç e mund të bëhesh edhe shtetas italian!". Është kartolina që në Milano po u mbërrin me postë 480 bijve të imigrantëve të lindur në Itali që mbushin moshën madhore. Një iniciativë e bashkisë, më saktë, e drejtorit për politikën shoqërore, Pierfrancesco Majorino, për t'u kujtuar atyre një nga normat e ligjit mbi shtetësinë.

Është neni 4, paragrafi 2 i ligjit 91 të vitit 1992 që parashikon "që bijnë e imigrantëve të lindur në Itali që kanë jetuar këtu rregullisht për 18 vjet me radhë mund të marrin shtetësinë italiane, me kusht që të deklarojnë këtë dëshirë përpara nëpunësit të zyrës së Gjendjes Civile para se të mbushin 19 vjeç".

Me të kapërcyer moshën 19-vjeçare, duhet t'i drejtohen ministrisë së Brendshme, përmes Prefekturës, duke hapur një procedurë shumë më të gjatë e të kushtueshme.

"Janë të paktë të rinjtë që e dinë këtë mundësi që u jep ligji" shpjegon Majorino, dhe nisma e administratës së Milanos mund t'i dhurojë Italisë shumë shtetas të rinj.

Letrat do të nisen bijve të imigrantëve të lindur në Itali deri në vitin 2016, çdo tre apo gjashtë muaj, në bazë të ditëlindjeve.

Nuk do t'u hyjë në punë qindra mijëra bijve imigrantësh të ardhur të vegjël apo të lindur në Itali, që nuk mund të dokumentojnë rezidencën e vazhdueshme dhe të rregullt për tetëmbëdhjetë vjet. Fatkeqësisht, për ta ligji mbi shtetësinë nuk parashikon asnjë rrugë të shkurtër.

iniciativave pozitive tashmë të nisura nga Komuna ime e nga të tjera Komuna italiane".

Sipas Flavio Zanonato-s, kryebashkiak i Padovas dhe nënkryetar i ANCI-t me prokurë për politikën e imigracionit, "e kemi për detyrë të mundësojmë brezat e dytë e të tretë që të mund të kontribuojnë në rritjen e zhvillimin e Vendlit që është edhe atdheu i tyre. Kapitali njerëzor - përfundon Zanonato - është në fakt burimi më i madh që ka në dispozicion një Vendl".

Raffaella Milano, Drejtoreshë e Programit Itali-Europë e organizatës Save the Children Italia konsideron të domosdoshme "një ndërhyrje të koordinuar normative, arsimore dhe shoqërore, për të shoqëruar në mënyrë të qëndrueshme këtë proces integrimi, duke filluar nga komunitetet lokale. Me urimin që Italia të ketë sa më parë një reformë të shtetësisë që t'i bëjë të ndihën krejtësisht italianë djemtë e vajzat që lindin e rriten në këtë Vendl, duke zotëruar të njëjtën gjuhë e duke ushqyer të njëjtat pasione dhe ëndrra të bashkëmoshatarëve të tyre".

"Rrjeti G2-Brezat e Dytë - komenton zëdhënësi, Mohamed Abdalla Tailmoun, mbështet e nxit me forcë këtë iniciativë në favor të bijve të imigrantëve që hyjnë në moshën madhore. Është e rëndësishme që brezat e dytë të lindur në Itali të ushtrorjnë të drejtën e tyre të zgjedhjes sipas nenit 4 të ligjit 91 të vitit 1992. Ky nen bazohet në parimin e ius soli, parim themelor që ne mendojmë se duhet të frymëzojë reformën e këtij ligji. Jemi plotësisht të bindur se tashmë është koha që Italia të jetë Vendi i të gjithë bijve të saj pa asnjë diskriminim".

CHIARI, QYTETI-SHTET LEGIST që nuk lejon martesën e klandestinëve

Një urdhëresë e kryetarit të komunës detyron ata që kërkojnë të martohen të tregojnë lejen e qëndrimit. Është e njëjta normativë që në korrik u hodh poshtë nga Gjykata Kushtetuese

Nuk mjaftonin Vatikani dhe San Marino. Tashmë duket se edhe Chiari, njëzetmijë banorë pak kilometra larg Brescias, është kthyer në qytet-shtet, me ligje të tijat që nuk duan t'ia dinë për Kushtetutën italiane. Është qyteti që po prin Secesionin (ndarjen nga Italia) që vazhdon të jetë temë e ëndrrave të Legës së Veriut.

Praktikisht, një urdhëresë e fundit e kryetarit të komunës Sandro Mazzatorta, legist i dyzuar mes fashës trengjyreshe dhe një kolltuku të Senatit, detyron imigrantët që duan të martohen të paraqesin lejen e qëndrimit. Pra duke risjellë në fuqi ndalimin e martesës për klandestinët, ndalim që u hodh poshtë nga Gjykata Kushtetuese.



Duke mos mjaftuar gjykimi i shëndoshë, u desh një sentencë e Gjykatës Kushtetuese për të zhdukur një nga padrejtsitë më të dukshme të ligjit mbi sigurinë të vitit 2009. Sipas gjykatësve, shkelte të drejtën themelore të individit për të krijuar familje, dhe ky ishte një dëm shumë më i lartë nga objektivi që kërkohet të arrihej me sjelljen në fuqi të normës: të luftonte imigracionin klandestin dhe marte-

sat për leverdi. Por në Chiari, sipas Mazzatortas, "Lega nuk dorëzohet, dhe vazhdon të çojë përpara mosbindjen civile në respekt të ligjit dhe në të mirë të sigurisë së qytetarëve". Si e bën këtë? "Duke u mbështetur në një normë ligjore mëse të qartë - shpjegon kryetari i komunës - që parashikon paraqitjen e dokumenteve për çiftet që kërkojnë shpalljen e martesës. Urd-

hërohet që në kuadrin e dokumentacionit të nevojshëm për shpalljen e martesës duhet domosdoshmërisht të paraqitet nga i huaji i interesuar edhe leja apo karta e qëndrimit e vlefshme, siç parashikohet nga neni 5 i dekretit legjislativ 286/1998".

Por meqë Gjykata kushtetuese e hodhi poshtë normën e kërkuar nga Maroni, mjafton edhe gjykatësi më pa eksperiencë për të shumëzuar me zero pretendimet e Mazzatortas. Ndërkohë, ama, kushedi sa të rinjve po u hap telashe. Edhe sepse në administratën e Chiarit shpresojnë të ndiqen nga të tjerë. "Qëllimi ynë është - thotë kryetari i qytetit-shtet, - t'u tregojmë rrugën të gjithë atyre administruesve që duan të ndjekin rrugën e rreptësisë dhe të drejtësisë".

E.Pasca

Jo me perçe në publik

Në fund të tetorit, Dhoma e Deputetëve do të diskutojë një projektligj që ndalon mbulimin në publik të fytyrës

Ashtu si Belgjika, Holanda e Franca, edhe Italia po ndalon përdorimin në publik të perçes, burkës, nihabit apo vellove të tjera që mbulojnë fytyrën. Në të vërtetë janë pak të përhapura ndër komunitetet myslimane që jetojnë këtu, por shpesh kanë përfunduar në qendër fushatash të debatuar mediatike.

Në fund të tetorit, Dhoma e Deputetëve do të diskutojë një projekt ligj që ndalon mbulimin në publik të fytyrës me veshje të çdo lloji, përfshirë ato me origjinë etnike apo kulturore. Përjashtimet e vetme të lejuara janë ato të diktuar nga arsye shëndetësore, profesionale apo të lidhura me manifestime sportive, artistike ose tradicionale.

Kush nuk respekton ndalimin do të rrezikojë nga 300 deri në 500 euro gjobë, që gjykatësi i paqes mund të kthejë në punë të detyrueshme falas pranë shoqatave që merren me integrimin. Padyshim më të rënda ndëshkimet për ata që detyrojnë dikë të mbulohet, vepër penale e dënueshme me burgim deri në një vit, gjobë deri në 3 mijë euro dhe hedhjen poshtë automatikisht të një kërkesë të mundshme për shtetësinë italiane.

Një kompani shqiptare lundrimi mbulon linjën Durrës-Bari

ËSHTË THEMELUAR NË DURRËS KOMPANIA E PARË SHQIPTARE E LUNDRIMIT ALBANIAN FERRIES QË PREJ DY JAVËSH KA NISUR UDHËTIMET NË LINJËN DURRËS BARI ME TRAGETIN E SAJ ADRIATICA QUEEN. SHUMË SHPEJT DO TË NISË LUNDRIMET EDHE ADRIATICA KING

Prej disa javësh në linjën detare Durrës-Bari-Durrës ka nisur të lundrojë trageti "Adriatica Queen". Është ky trageti i parë i të parës kompani lundrimi shqiptare, "Albanian Ferries" të themeluar reth dy muaj më parë nga pesë biznesmenë shqiptarë në fushën e transporteve. Brenda tetorit, kompania shqiptare do të mbulojë linjën Durrës-Bari me një tjetër traget, që quhet "Adriatica King".

Aurel Kaçulini, administrator i agjencisë KAD, agjencia e përgjithshme e "Albanian Ferries", thotë "Kompania Albanian Ferries lindi si nevojë e transportuesve të kamionëve, të cilët ndienin mungesën e seriozitetit në tregun e lundrimit, që dominohet nga të huajt. Rezervimet e vështira veçanërisht në periudhat e fluksit të lëvizjes së udhëtarëve dhe ndryshimet e çmimeve të lundrimit në vartësi të kërkesave, ishin dy elementët kryesorë që bashkuan pesë firma të njohura në fushën e transpedicionit".

Janë drejtuesit e kompanisë "Pelikan", Genc Mataj, e kompanisë "Muka speed", Ardian Muka, e "Konserv-Alba", Etrit dhe Ardian Hasnedari, e "Shega Trans", Ervin Shijaku dhe drejtuesi i "Lami Trans", Xhaferr Lami, që pas një përgatitjeje gati njëvjeçare, krijuan kompaninë krejtësisht shqiptare "Albanian Ferries", për transportin e udhëtarëve dhe automjeteve, në një treg të mbuluar për 20 vjet nga kompani të huaja, kryesisht italiane dhe greke.

"Trafiku vjetor i kamionëve gjatë vitit 2010 vetëm në linjën Durrës -Bari dhe kthim ka pasur një vëllim vjetor prej 27.700 automjeteve të mëdha në largim nga Durrësi dhe 28.800 të tjerë në mbërritje. Pa mbajtur parasysh lëvizjet drejt porteve të Ankonës dhe Triestes këto janë shifra të larta dhe një pjesë e mirë e kamionëve të transportuar janë në pronësi apo në shërbim të kompanive transportuese, të cilat vendosën krijimin e një kompanie shqiptare lundrimi si dhe blerjen e dy trageteve të mëdha" sqaron Aurel Kaçulini.

Trageti "Adriatica Queen" është blerë në Estoni dhe ka një gjatësi prej 153,8 metra. Mban 1300 udhëtarë që mund të akomodohen pjesërisht në 260 kabinat me 708 shtretër, ndërsa kapaciteti i automjeteve arrin në 30 kamionë dhe 50 autovetura së bashku.

"Adriatica King" i blerë në Greqi

dhe që pret të nisë lundrimet brenda këtij muaji është diçka më i vogël (123 metra) me kapacitet udhëtarësh 1200 vetë si dhe të njëjtin kapacitet automjeteve me "Adriatica Queen": 30 kamionë dhe 50 autovetura.

Sipas Kaçulinit, "tragetet e kompanisë shqiptare do të kenë siguri dhe komoditet të plotë në lundrim. Sa për çmimet, ato janë e do të mbeten padyshim konkurruese". "I kërkojmë shtetit të kontrollojë re-



spektimin e tabelave të çmimeve të paraqitura nga kompanitë, çka do ta bëjë tregun e lundrimit detar shumë më serioz në marrëdhëniet me part-

nerët dhe klientët" përfundon drejtuesi i agjencisë detare të kompanisë "Albanian Ferries".

CENSUS - SHQIPËRI

Numërohen deri tani 52% e banesave

Në dhjetë ditët e para të censusit mbarëvajtjae Censusit ka qenë edhe më e mirë nga parashikimet e INSTAT-it. Asnjë koment mbi problemet e botuara në media por pranohet vetëm që "duke qenë një proces madhor, Censusi ka problemet e veta"

Instituti i Statistikave raporton se gjatë dhjetë ditëve të para të censusit ka përfunduar numërimi i 535.300 ose 52% e banesave në të gjithë territorin shqiptar. "INSTAT kishte përllogaritur që deri më datë 10 tetor të ishte numëruar 49,4% e banesave dhe shifra që ne kemi deri në këtë ditë është mbi këtë mesatare" bëri të ditur zëdhënësja e INSTAT-it, Vjollca Simoni.

Sipas raportimeve nga zyrat periferike në terren procesi i censusit ka pasur mbarëvajtjen më të mirë në Dibër (numëruar 67% e banesave), Pogradec (62%), Berat (58%) dhe Lezhë (56.7%). Ndërkohë që në Tiranë janë numëruar

50,2% e ndërtesave.

"Sigurisht një proces madhor siç është censusi, ka edhe problematikën e vet. Në disa raste, janë dashur pyetësor dhe anketues shtesë për shkak të intensitetit më të lartë të banesave në disa zona", tha Simoni. Sipas saj, "Deri në ditën e dhjetë, Censusi në terren po ecën sipas parashikimeve dhe problemet që janë hasur kanë gjetur zgjidhje të menjëhershme nga përgjegjësit e INSTAT në rrethe". Por zëdhënësja kalon me "asnjë koment" problemet e publikuar në media si rastet e anketuesve që i shënojnë të dhënat vetëm me laps e jo me stilolaps, apo fakti që zona të

tëra në Korçë kërkojnë fotokopje të formularëve për t'ia dorëzuar në Ambasadën Greke.

"INSTAT fton të gjithë qytetarët t'u hapin dyert anketuesve për të përfunduar këtë proces me sukses", u shpreh Simoni.

Censusi i popullsisë dhe banesave është numërimi i të gjithë njerëzve, banesave dhe pronave brenda territorit të Shqipërisë në një kohë të caktuar. Ai është një imazh statistikor që tregon, përmes të dhënave, kush jeton në Shqipëri, kushtet socio-ekonomike dhe kushtet e jetesës. Censusi është një nga veprimtaritë statistikore më të rëndësishme, e cila siguron një informacion të detajuar mbi numrin dhe strukturën e popullsisë, e krahasueshme edhe në njësi shumë të vogla gjeografike. Censusi nuk ka të bëjë me regjistrat e taksave, pensione, pronësisë, shpërndarjes se energjisë elektrike apo statusit të emigrantit.

Nga Elton XHANARI, Brescia

B

iznesi i trafikimit ilegal të plehrave toksike, gjatë 15 viteve të fundit, ka helmuar territorin e Napolit dhe Kazertës. Fjala "helmim" nuk është figurë letrare, por fakt tragjik, duke pasur parasysh se këto dy provinca kanë përqindjen e vdekshmërisë nga tumori, më të lartë në Itali. Sipas një studimi të Mbrojtjes Civile, napolitanët dhe kazertanët, janë më shumë të prekur nga tumoret në mëlçi (4% burrat, 7% gratë), tumoret në stomak (5% burrat), keqformimet gjenetike mbi sistemin nervor (8% pa diferencë gjinie), dhe të aparatit uro-gjenital (14% pa diferencë gjinie).

Zinxhiri kriminal është i thjeshtë: industrinë e veriut, sipas ligjit, duhet të paguajnë ndërmarrje të specializuara për bonifikimin e mbetjeve toksike të prodhuara nga makineritë e tyre. Kamorra napolitane, krijon ndërmarrje "fantazmë" duke premtuar trajtimin e këtyre mbetjeve me më pak se gjysmë çmimi. Në vend të trajtimit, grupi mafioz, falë falsifikimit të letrave shoqëruese, gëpus lëndët toksike në provincat e Napolit dhe Kazertës. Sipërmarrësit e veriut kursejnë

Aleanca Kuq e Zi: "40% refuzon t'u përgjigjet pyetjeve mbi kombësi e fe"

Edhe pas dhjetë ditëve nga nisja e censusit, në Shqipëri nuk ndalen iniciativat e Aleancës Kuq e Zi, lëvizja qytetare që mbledh rreth vetes shoqata e intelektualë, që ka kërkuar gjithnjë heqjen e pyetjeve mbi kombësinë e fenë. Fillimisht Aleanca ka ftuar shqiptarët të grisin faqen e formularit me pyetjet mbi këto dy tema, sidoqoftë të mos u përgjigjen atyre dy pyetjeve. Një javë nga nisja e regjistrimit të popullsisë, ka deklaruar se, sipas të dhënave të mbledhura prej saj gjatë monitorimit të procesit, 40% e popullsisë nuk i është përgjigjur pyetjeve mbi fenë dhe kombësinë. Në një komunikatë shtypi ajo deklaroi se "tentativa për të vendosur pyetjet mbi kombësinë dhe fenë kundër vullnetit të popullit dhe kundër parimeve Kushtetuese, mund të quhet e dështuar" dhe kujton se, sipas parimeve të Eurostat-it, nëse 5% e të intervistuarve refuzon të përgjigjet, rezultatet mbi këto pyetje nuk duhet të merren në konsideratë në përgatitjen e raportit përfundimtar.



Më 22 Shtator 2011 Kuvendi vetëm me 69 vota, votoi miratimin e ligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

Referendum apo opozitë plehrash?

E VETMJA MËNYRË PËR TË SHPËTUAR EDHE ATË PAK SHQIPËRI QË KA NGELUR, ËSHTË REFERENDUMI POPULLOR NË BAZË TË NENIT 150 TË KUSHTETUTËS. MJAFTOJNË 50 MIJË FIRMA TË SHTETASVE ME TË DREJTË VOTE, PËR TË KËRKUAR REFERENDUM SHFUQIZUES. TË PAKTËN TË KEMI MUNDËSINË T'I "BËJMË VARRIN VETES", DHE TË MOS TË LEJOJMË QË VARRIN TË NA E BËJNË 69 POLITIKANË

mbi bonifikimin, kamorra pa-surohet me ato para dhe ndërkohë helmon tokën e vet. Pa asnjë skrupull.

Por toka është e kufizuar dhe Kamorra është gjithmonë në kërkim të hapësirave të reja ku të groposë mbetjet toksike. Organet e hetimit italiane, kanë vërtetuar se si trafiku i plehrave është zhvilluar edhe me vendet fqinje si Gjermani, Rumani deri edhe në Kinë (nëpërmjet konteinereve).

Nëse administrata e këtyre shteteve ka qenë e pafuqishme përpara mafies italiane, sa shpresa kanë doganat tona të kontrollojnë me imtësi cilësinë e plehrave që do të importohen në bazë të ligjit 10463 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"?

Për të qenë të saktë, ligji nuk është dekretuar akoma nga Presidenti, pra nuk ka hyrë në fuqi, por pak shpresa ka që presidenca aktuale ta rikthejë në Parlament për rishqyrtim. Vetoja e Presidentit është e përkohshme, sepse votimi i dytë e bën dekretimin të detyrueshëm, por do të ishte një akt guximi në dobi të kombit. Vështirë që zoti Topi, i cili kishte frikë nga gurët e militantëve të partisë së vet, t'i futet kësaj rruge.

Pra, duke e marrë të mirëqenë shpalljen e ligjit në Fletoren Zyrtare, e vetmja mënyrë për të shpëtuar edhe atë pak Shqipëri që ka ngelur, është referendum i popullor në bazë të nenit 150 të Kushtetutës. Mjaftojnë 50 mijë firma të shtetasve me të



Nëse me të vërtetë opozita është ndryshe, e ka për detyrë të shfrytëzojë edhe instrumentin e fundit që kushtetuta i jep për të parandaluar shpërthimin e një bombe ekologjike që kërcënon themelet e brishta të Shqipërisë

drejtë vote, për të kërkuar referendum shfuqizues. Të paktën të kemi mundësinë t'i "bëjmë varrin vetes", dhe të mos të lejojmë që varrin të na e bëjnë 69 politikanë.

Ndoshta e vetmja forcë e organizuar në gjendje të mbledhë kaq shumë firma në pak kohë, është Partia Socialiste e cila, në këtë mënyrë, mund të lajë edhe mëkatën e kryer gjatë miratimit të ligjit, duke lejuar arritjen e kuorumit me qëndresën në sallën e kuvendit.

Ky diletantizëm politik (çudi që vjen nga një "ujk i vjetër" si Gramoz Ruçi), do të falej nga një fushatë e gjerë informacioni mbi një çështje jetësore për të gjithë shqiptarët. Do të ishte e nevojshme një përgjigje zyrtare nga selia

rozë, për të kuptuar njëherë e mirë nëse rreziku i helmimit të popullit të vet, përbën apo nuk përbën prioritet për socialistët.

Nëse me të vërtetë opozita është ndryshe, e ka për detyrë të shfrytëzojë edhe instrumentin e fundit që kushtetuta i jep për të parandaluar shpërthimin e një bombe ekologjike që kërcënon themelet e brishta të Shqipërisë. Rama me shokë kanë mundësinë më të mirë për të luftuar për një kauzë të prekshme dhe të drejtë. Përndryshe, nga bashkëfajtorë, do të ktheheshin në bashkëpunëtorë, dhe nuk do të na ngelej veçse një thirrje: Zoti na ruajtë!

Botuar në Shekulli

**NGA 7.000 €
DERI NË 9.999 €**

**NGA 4.000 €
DERI NË 6.999 €**

**NGA 2.000 €
DERI NË 3.999 €**

**NGA 1.000 €
DERI NË 1.999 €**

RISI

TË MREKULLUESHME

SHTOJI 1€*

**SHPENZIMEVE TË TUA
DHE ÇON NË SHTËPI
SHUMË MË TEPËR**

**Bli mobilie dhe orendi shtëpiake
nga 1.000€ deri në më shumë se
10.000€, shto vetëm 1€ dhe do të
kesh menjëherë shumë produkte
dhe udhëtime!**

UNIVERSI I KURSIMIT

*Behet fjalë për shitje të çifitëzuara, kërkohet informues dhe rregulloren në pikat e shitjes. E vlefshme nga 10/09 deri më 31/12/2011. Ndërmarrja ruan të drejtën e zëvendësimit të produkteve me të tjera të të njëjtes vlerë, sipas mallrave në dispozicion. Markat dhe karakteristikat teknike të mallrave, në dispozicion në pikat e shitjes. Pushimet jepen përmes "travel card Iperclub", teserë e lëshuar nga Shoqëria IPERCLUBVACANZE spa, e para-paguar me një numër pikesh të mjafitueshme për pushimet e reklamuar apo të ngjashme, pushimet mund të zgjidhen ndër ato të katalogut Travel Card Iperclub përmes call center-it të Iperclub Vacanze spa në numrin 06/303030 dhe varen nga disponibiliteti i destinacioneve dhe i periudhës, i verifikueshëm përmes call center-it të Iperclub Vacanze spa.

Ndalet në aeroport të Rimitit një shqiptar me pasaportë greke të falsifikuar

Policia e kufirit e aeroportit të Rimitit arrestohen dy vetë: Klevis Jakun klandestin, që me pasaportë greke të falsifikuar më së miri përpiquej të shkonte në Angli dhe Jak Tokrrin pse e kishte ndihmuar



Jaku dhe ta arrestonin. Me proces gjyqësor të menjëhershëm Jakut iu dhanë 10 muaj burg.

Nga kontrollat e mëtejshme forcat e rendit zbuluan se një tjetër shqiptar ishte i implikuar me këtë çështje: Jak Tokrri, 45 vjeç, banor i rregullt në Cervia, kish ndihmuar 23-vjeçarin për të shkuar në Angli. I kishte blerë biletën dhe i kishte mbajtur pasaportën e tij shqiptare.

Tokrri, i arrestuar në banesën e tij në Cervia, rrezikon tani një dënim edhe më të rëndë: deri në 15 vjet burg për favorizim të emigracionit klandestin.

Nuk është herë e parë që zbulohen jokomunitarë nga vende me emigracion të fortë me pasaporta të vendeve anëtare të BE-së, apo sidoqoftë vendeve nga të cilat nuk ka fluks të lartë emigrantësh të parregullt. Policia bën të ditur se tashmë ndodh shpesh të zbulohen jo vetëm shqiptarë me pasaportë greke por edhe rusë që hiqen si polakë ose hungarezë, apo kinezë që hiqen si tajlandezë apo japonezë.

Edhe pse pasaporta greke biometrike që mbante ishte e falsifikuar shumë mirë, fjalët e policisë, 23-vjeçari Klevis Jaku nuk arriti t'ia hidhte e të merrte avionin e Ryanair-it për në Londër. Më 8 tetor në darkë, në aeroportin e Rimitit, policia e ka ndjekur grupin e shqiptarëve që do të fluturonte drejt Anglisë, duke dyshuar se mes tyre mund të kishte klandestinë. E nuk gaboi. Gjatë kontrollit shqiptari ka treguar pasaportën greke, që sipas policisë, ishte e falsifikuar shkëlqyer, edhe në mikroçip, por ky fakt nuk pengoi forcat e rendit të verifikonin që ai ishte Klevis

Paradë kuq e zi rrugëve të Nju Jorkut

Aleanca Kuq e Zi nis maratonën e saj. Ndalesa e parë, më 10 tetor në Nju Jork, në ditën e Kolombit. Më 17 tetor takim në Romë

"Shqipëria duhet të bëhet, por duhet të bëhet me ata që mendojnë kuqezi. Një pjesë, Atdheun tonë e skuqi, pjesa tjetër e politikës e nxu. Ka ardhur koha që Shqipëria as të mos skuqet as të mos nxihet, por të jetë kuqezi". Kështu është shprehur dje në Nju Jork Kreshnik Spahiu përpara qindra shqiptarëve që kanë dalë të festojnë në ditën e Kolombit të mbledhur nga organizata Rrënjët shqiptare.

Atmosfera e manifestimit të djeshëm, që zgjati rreth tre orë, u ndez nga disa këngëtarë të njohur si Frederik Ndoci, Çiljeta, Genta Ismaili. Kjo e fundit këndoi edhe himnin e Aleancës Kuqezi, të prezantuar për herë të parë.

Kjo e Nju Jorkut është edhe etapa e parë e Maratonës Kuq e Zi, që ka për qëllim promovimin dhe mbrojtjen e vlerave kombëtare dhe historike kudo që jetojnë shqiptarë, në trojet e tyre apo edhe në diasporë. Në Romë, maratona do të mbërrijë më 17 tetor. Atë ditë, në universitetin "La Sapienza" do të mbahet një takim me zëvendës kryetarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kreshnik Spahiu. Do të marrë pjesë edhe futbollisti Lorik Cana, gjithnjë i ndjeshëm ndaj çështjeve kombëtare.

PUNËTORËT SHQIPTARË Shembull në punë, për dinjitet e profesionalizëm

Eshtë bukur të lexosh herë pas here në mediat italiane shkrime mbi shqiptarët që nuk kanë të bëjnë me kronikën e zezë, por që flasin për punën e aftësitë e tyre. Si ai i të përditshmes Il Giornale që sjell në vëmendjen e lexuesve punën e shkëlqyer të kryer nga një skuadër punëtorësh shqiptarë në mirëmbajtjen e disa rrugëve në qendër të Genovas.

Sipas shkrimit, për disa ditë me radhë një skuadër punëtorësh ka punuar në rrugicat e qendrës historike për ndërrimin e tubave të ujit. Prishin asfaltin, ndërrojnë tubat e shumë shpejt mbyllin e asfaltojnë gjithçka duke u thyer banorëve rrugët në kohë rekord.

Dhe "janë të gjithë shqiptarë" thotë disi me çudi shkruesi që vazhdon me "Mrekullia qëndron në faktin se si kanë vënë në vend të vet gjërat me të mbaruar punë: Vico Pece nuk ka qenë kurrë ndonjëherë kaq i pastër, i rregullt... Kam mbikëqyrur gjatë punën e atyre punëtorëve: ditën të vinin në vendin e vet çdo gur antik, pasi i pastruan një e nga një, dhe mes çdo guri hodhën e niveluan me maksimumin e kujdesit çimenton".

Kush shkruan lavdëron shqiptarët për punën e bërë më së miri, pa fjalë të tepërta e pa mllef. "Shqiptarët ishin seriozë por jo të zymtë, e kur u bëra një lëvdatë, fytyrat e tyre u çelën nga një buzëqeshje e bukur, me dinjitet por edhe të kënaqur e mirënjohës për vlerësimin".

Shpesh të qëllon të hasësh

„ Nëse italianët do të arrinin të kuptonin që ekziston një etikë pune, që të punosh mirë diçka është detyrim, dhe nëse do të silleshin me të njëjtin dinjitet të atyre shqiptarëve, gjërat do të shkonin më mirë në këtë vend

rrugëve italianë teksa kryejnë punime të ndryshme për mirëmbajtjen e rrugëve por "janë të pakënaqur, me turinj, të sertë e punojnë si të ishin "të detyruar", duke sharë nëpër dhëmbë".

Ndërsa për skuadrën e shqiptarëve, vazhdohej me: "i kam parë edhe herë tjetër këta shqiptarë, kur ribënë e dekoruan pallatin mes San Bernardo e sheshit Em-briaci. Realizuan një kryevepër të vogël profesionale, dhe kam vërejtur atë që është mënyra e tyre normale e të punuarit, ajo që u lejon që kur mbarojnë gjithçka të sodisin me admirim një punë të kryer siç duhet".

"E nëse italianët do të arrinin të kuptonin që ekziston një etikë pune, që të punosh mirë diçka është detyrim, dhe nëse do të silleshin me të njëjtin dinjitet të atyre shqiptarëve, gjërat do të shkonin më mirë në këtë vend" mbyllet shkrimi.

Shqiptari i guximshëm u prish planin hajdutëve të fqinj

Mediat Arezzonotizie.it e La nazione sjellin ditët e para të tetorit në faqet e tyre internet rastin e një shqiptari "të guximshëm", siç e quajnë ato, në San Giovanni Valdarno që me të dëgjuar zhurma në apartamentin e fqinjit, nuk mendohet dy herë por del nga shtëpi e tij e përpiket të ndalë dy hajdutët. Nuk ia arrin, përkundrazi merr një grusht në fytyrë, por fiton edhe simpatinë e vendasve.

Praktikisht ngjarja është e të shtunës mbrëma. Shqiptari, rezident në një pallat në rrugën Giotto në qendër të San Giovanni Valdarnos, ka dëgjuar zhurma që vinin nga apartamenti përbri të tij. Është ngritur e ka dalë për të parë ç'ndodhte, kur ka parë nëpër shkallë dy persona që largoheshin me vrap, ndërsa alarmi i shtëpisë së fqinjit, që personat ishin përpjekur të hapnin, kish nisur të binte. Duke kuptuar se dy burrat që ia kishin dhënë vrapit, ishin përpjekur të hapnin apartamentin e fqinjit, u është vënë nga pas dhe është përpjekur t'i ndalojë, por njëri prej tyre është kthyer dhe e ka goditur fort me grusht në fytyrë.

Karabinierët e San Giovanniit kanë mbërritur në vendngjarje e kanë nisur hetimet, ndërsa shqiptarin e kanë çuar ta mjekojnë në spital.

Dj Edi
Muzike e zgjedhur shqiptare per gezimet tuaja familjare
cel: **3311551939**

Banka jote është e gjitha këtu.



Carta Enjoy. Gjithçka që të nevojitet me vetëm 1€ në muaj!

Për të pasur gjithçka, pa pasur llogari.

Enjoy të lehtëson jetën, sepse të jep të gjitha avantazhet e një llogarie rrjedhëse, pa pasur një llogari rrjedhëse. Për të akredituar rrogën, për të blerë në të gjitha dyqanet dhe në internet, për të tërhequr para falas në mbarë Italinë pranë sporteleve ATM dhe jashtë shtetit në qarkun Mastercard, për të ngarkuar celularin, dhe për shumë shërbime të tjera, zgjidh komoditetin. Zgjidh Kartën Enjoy.

Eja menjëherë në UBI Banca! Për të gjetur filialin më të afërt vizito faqet internet www.ubibanca.com/nuovi-italiani ose telefono në numrin e gjelbër 800 759 759.

PËR MË TEPËR MUND TË DËRGOSH PARA ME



UBI Banca

Mesazh reklamues me qëllime promovimi. Për kushtet e kontratës shiko fletët informuese në të gjitha filialet e Bankave të Grupit UBI Banca.

800.759.759 - www.ubibanca.com

Arrestohet 50 vjeçari për dhunë ndaj të shoqes

Një histori e tmerrshme familjare merr fund: policia e Ternit ka arrestuar një shqiptar me akuzat e keqtrajtimit, lëndimit dhe dhunës seksuale në familje

Nga 1992-shi kur u martua, vetëm rrahje sharje dhe marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e saj. Kjo ishte jeta për 43 vjeçaren shqiptare që në korrik paditi të shoqin te forcat e rendit.

Policia e Ternit nis hetimet e zbulon një histori të tmerrshme e të dhimbshme familjare: dhunë fizike dhe psikologjike e vazhdueshme e një murratori shqiptar 50-vjeçar, shpesh i dehur, ndaj të shoqes dhe tre bijve të tij që shpesh vendosin të mos shkojnë as në shkollë për t'i qëndruar pranë të ëmës, gruaja që detyrohet me forcë të ketë marrëdhënie seksuale e bijtë që dëgjojnë ulërimat kundërshtuese të të ëmës.

Çifti ishte martuar në Shqipëri në vitin 1992 e burri shpesh dehej e rrihte të shoqen. Më pas emigroi në Itali dhe situata nuk ndryshoi as kur e shoqja erdhi në Terni me të bijtë falë bashkimit familjar në vitin 2005. Shpresonte për një jetë më të mirë gruaja por përkundrazi dhuna e të shoqit u shtri edhe mbi tre fëmijët e çiftit, që tashmë të rritur përpigën të mbrojnë të ëmën nga egërsia e babait.

Të shumta rastet kur 43 vjeçarja shqiptare - herë pas here në punë pranë ndonjë familjeje për të bërë punët e



shtëpisë - është përzënë nga shtëpia bashkë me fëmijët nga i shoqi i dehur, apo është detyruar t'ia mbathë e të shkojë tek e motra për t'i shpëtuar dhunës. Shpesh gruaja ka përfunduar në repartin e Ndihmës së Shpejtë, por gjithnjë ka

sajuar shkaqe nga më të ndryshme për të nxirat dhe plagët që ka në trup. Në prill episodi më i dhunshëm: ndërsa lante pjatat, i shoqi i ka vënë thikën në fytyrë të tre bijve. Duke u përpjekur të mbrohej gruaja ka marrë një plagë të thellë në dorë për të cilën iu nënshtrua edhe një ndërhyrje kirurgjikale.

Në korrik dhuna përsëritet e këtë herë i shoqi i është vërsulur të birrit. E trembur për jetën e djalit gruaja thërret forcat e rendit e këto nisin hetimet.

Del në dritë që gruaja me të bijtë shpesh i janë lutur babait të familjes të largohej nga shtëpia duke e kërcënuar se në të kundërt do ta denonconin, por 50-vjeçari premtojte se do të ndryshonte, shkonte edhe te njerëzit e gruas për të kërkuar ndjesë, por brenda 24 orëve niste sërish avazin.

Dhuna e fundit në familje ditët e fundit të shtatorit kur sheh të bijën që trukohet përpara pasqyrës: sharje e shpulla. Por këtë herë 50 vjeçari nuk e ka të gjatë: të premtën (më 30 shtator) në mëngjes, falë një urdhër arresti të gjykatës për hetimet paraprake, agjentët e policisë e kanë arrestuar pranë stacionit hekurudhor ku burri duhet të merrte trenin për të shkuar në punë. Sot gjendet në burg me akuzat e keqtrajtimit, lëndimeve të rënda dhe dhunës seksuale në familje.

Duhet të vuajë tetë vjet heqje lirie për vrasje me dëshirë, sipërmarrësi

50-vjeçar nga Arzago d'Adda, Antonio Monella, që natën duke gdhirë 6 shtatori 2006 qëlloi me armë zjarri mbi hajdutin që po i largohej nga shtëpia. Hajduti, Elvis Hoxha, që vdiq brenda pak orëve në spital, ishte vetëm 19 vjeç.

Antonio Monella, sipërmarrës ndërtimi nga Arzago d'Adda, i zgjaur në mes të natës nga zhurmat e hajdutëve që po i vidhnin makinën, Monella nuk u mendua dy herë, i roku pushkën, doli në ballkon dhe shtiu. Një nga plumbat goditi makinën e tij, ndërsa një tjetër një nga tre hajdutët. Këta heqin dorë nga vjedhja e Mercedesit të Monellos, shkojnë me vrap drejt makinës me të cilën kishin ardhur dhe zhduken në errësirë. Pas nja një ore, pranë një lokali në Truccazano, në afërsi të vilës së sipërmarrësit, gjejnë Elvisin në gjendje tepër të rëndë, të plagosur me armë jarri në gjoks, ndaj edhe karabinierët kuptojnë menjëherë që është djali i qëlluar nga Monella. I dërguar menjëherë në spitalin e Melzos, vdes pas pak orësh. Elvis Hoxha ishte në Itali prej dy vjetësh dhe nuk

SHKURT

Aksident në punë. Djegie të rënda për dy punëtorë

25 vjeçari Albi Alleshi dhe boshnjaku 39 vjeç Nedelco Derescko janë djegur, në zjarrin që ka shpërthyer në impiantin e shkatërrimit dhe të riciklimit të plehrave në Pontedera

Një aksident i rëndë ka ndodhur më 10 tetor në impiantin e shkatërrimit dhe të riciklimit të plehrave të ndërmarrjes Ecofor Service në Pontedera. Viktimat e aksidentit janë dy të huaj, 25vjeçari shqiptar Albi Alleshi dhe boshnjaku 39 vjeç Nedelco Derescko. Dy punëtorët, të punësuar nga një tjetër ndërmarrje, Ecospurghi Srl e Altopascio-s, ishin duke kryer operacione të mirëmbajtjes, kur ka marrë zjarr gazi i krijuar nga llumi që formohet në brendësi të impiantit. Gjithçka ka ndodhur papritur e dy punonjësit e kanë pasur të pamundur t'u shmangen gjuhëve të zjarrit.

Në gjendje më të rëndë është boshnjaku që ka marrë djegie në 70% të trupit, kryesisht në kokë dhe kraharor. Ndërsa Albi Alleshi, që banon në Altopascio, ka djegie në 50% të trupit. Ndihma e shpejtë e thirrur nga drejtuesit e Ecofor Service, ka qenë e menjëherëshme: në vendngjarje kanë mbërritur ambulancat që kanë çuar të djegurit në fillimisht në spitalin e zonës e më pas, boshnjakun në gjendje të rëndë në një spital të specializuar në Romë, ndërsa shqiptarin Alleshi në qendrën e për djegiet e Cisanellos në Pisa.

Blokohen në Vlorë 1,5 kg kanabis. Arrestohet mbajtësi

Në Vlorë arrestohet 23-vjeçari Ledjo Ndoni nga Fieri, që po transportonte 1,5 kg kanabis sativa për në Itali.

Nga ana tjetër e Adriatikut, forcat italiane të rendit sekuestrojnë 570 kg marijuanë e arrestojnë pesë shqiptarë

Policia e Vlorës bllokoi më 3 tetor një sasi prej 1,5 kg lëndë narkotike të llojit kanabis sativa, që do të trafikohet në Itali, dhe arrestoi poseduesin e saj, 23 vjeçar Ledjo Ndoni nga Fieri. Në këtë operacion të koduar me emrin "Trekëndëshi" u angazhuan Drejtoria Rajonale e Policisë së Kufirit dhe Migracionit si dhe strukturat e policisë së qarqeve Vlorë e Fier.

Burime zyrtare të policisë shpjegojnë se, lënda narkotike u gjet gjatë një kontrolli të policisë në pikën kufitare të portit të Vlorës. Ndoni që po udhëtonte me autobusin e linjës Vlorë-Firence, e kishte vendosur lëndën narkotike në çantën e tij të dorës, duke shpresuar të kalonte kontrollin e policisë.

Ndërsa më 13 tetor është sekuestruar në portin e Ankonës sasia më e madhe e drogës nga viti 2009. Një kontejner, në pamje të parë bosh, i zbritur në portin Ankonës nga trageti i nisur nga Durrësi, në të vërtetë fshihte një mall shumë fitimprurës. Plot 370 kg marijuanë të cilësisë së lartë të ndarë në 112 kuti, të futura në tavanin e dyfishtë të kontejnerit, me një vlerë, nëse hidheshin në treg për 3,5 milion euro. Kur, katër orë pas zbakimit të tragetit, një kamionist shqiptar ka ardhur të tërheqë kontejnerin, ka gjetur agjentët e financës me prangat gati për të.

Më 10 tetor, karabinierët e Romës kanë arrestuar në flagrancë shtatë vetë: 4 shqiptarë e 3 italianë, dhe kanë sekuestruar në Nettuno një TIR frigorifer që vinte nga Shqipëria me 200 kg marijuanë.

Shkelin arrestin e shtëpisë për të shkuar në restorant, apo për të bërë pazar

Brenda pak ditësh, dy raste të thyerjes së arrestit shtëpiak nga shqiptarë për të cilët gjykatësi ka vendosur të rrijë mbyllur në shtëpi.

Më i fundit në Faenze, më 9 tetor. Pasditën e të dielës karabinierët, gjatë shërbimit të kontrollit të territorit kanë arrestuar për 'arratisje' 33-vjeçarin Armand Tarellari, resident në Faenza. Tarellari duhet të ishte në arrest shtëpie por është kapur para një restoranti.

Pasi e mbajnë në paraburgim një natë, mëngjesin e të hënës e nxjerrin përsëri në gjyq në Ravenna, ku e dënojnë me katër muaj. Sërish me arrest shtëpie.

Një ngjarje e ngjashme ka ndodhur në Pistoia. Karabinierët gjatë perlustrimit të rrugëve, kanë ndaluar një 22 vjeçar shqiptar dhe kanë kryer menjëherë një verifikim në qendrën operative dhe kanë zbuluar se 22-vjeçari po vuante masën e arrestit të shtëpisë. Veç kësaj, në atë orë të ditës duhej të ishte në punë pasi, për një ri-integrim më të mirë në shoqëri, ishte autorizuar të punonte nga ora 7.30 e mëngjesit deri në darkë.

Ndërsa, më 7 tetor, kishte dalë për të bërë pazar në qendër të Pistoias, një shqiptar 22 vjeçar në arrest shtëpie. Për fatin e tij të keq është ndaluar rastësisht nga karabinierët rrugëve të qendrës që e kanë arrestuar. Këtë herë e kanë futur në burg.

Arrestohet në Rimini i shumëkërkuari Kastriot Dervishi

Beratasi 33 vjeçar duhet të vuajë 25 vjet burg për vrasjen e dy personave në Shqipëri

Me emër të rremë, jetë të thjeshtë e punë në të zehtë, ka arritur t'i shpëtojë drejtësisë shqiptare për 14 vjet. Kastriot Dervishi, 33 vjeç, është arrestuar sot në shtëpinë e tij në qendër të Rimini, ku jetonte bashkë me të shoqen dhe djalin 12 vjeç nga agjentët e policisë së qytetit.

Në vitin 1997, Dervishi ka vrarë Ali D.

dhe të birin, Ardian D, pasi ata pengonin martesën e tij me vajzën dhe motrën e tyre, duke menduar se ai do ta trafikonte për ta shfrytëzuar për prostitucion. Për këtë ngjarje ai është dënuar fillimisht nga gjykata e Beratit e më pas nga gjykata e Apelit e Vlorës me 25 vjet burg, me akuzat e vrasjes dhe të mbajtjes së armëve pa leje.

Nga ajo ngjarje duket se Dervishi ka jetuar kryesisht në Itali: Romë, Sassari e Rimini. Nga ky i fundit është dëbuar në vitin 2006 por ka arritur të kthehet shpejt.

Tani, është gjykata e Apelit të Bolonjës ajo që duhet të vendosë mbi ekstradimin e tij në Shqipëri.

Dënohet me 8 vjet sipërmarrësi që në 2006 vrau 19-vjeçarin Elvis Hoxha

Antonio Monella dënohet me proces të përshpejtuar për vrasje me qëllim. Në shtator 2006 qëlloi me armë zjarri dhe la të vdekur Elvis Hoxhën që po i vidhte makinën. Avokati shpresonte që klientit të tij t'i njihet mbrojtja e ligjshme



kishte dokumente qëndrimi. Avokati i sipërmarrësit, Enrico Mastropietro, u përpoq të kalonte vrasjen si "mbrojtje të ligjshme" dhe kishte kërkuar pafajësinë e plotë të klientit të tij. Sipas avokatit, në bazë të ligjit mbi mbrojtjen e ligjshme, në rastet e shkeljes në banesën private i zoti i shtëpisë mund të mbro-

het, për të tutëlur veten e tij, por edhe të mirat e tij materiale.

Mbi të shtënë e sipërmarrësit ka pasur një betejë edhe mes prokurorisë së Bergamos dhe gjykatës. Ekspertizat balistike të akuzës dhe të mbrojtjes kishin demonstruar që sipërmarrësi nuk kish marrë nishan për të vrarë një nga

keqbërësit që i kishin hyrë në shtëpi. Për këtë arsye prokuroria kishte ngulur këmbë të "teprira e pakujdesshme e mbrojtjes së ligjshme" dhe jo në "vrasjen me dashje".

Por sipas gjykatës se seancës paraprake, Bianca Maria Bianchi, nuk ishte mbrojtje e ligjshme (për të cilën nguli këmbë edhe avokati), sepse hajdutët po largoheshin, pra nuk po e kërcënonin më sipërmarrësin dhe ky ndërsa shkruhe armën duhet ta mendonte se mund të vriste ndonjë. Për këtë arsye dokumentacioni iu kthye prokurorisë dhe akuza u riformulua për veprën penale të vrasjes me dashje.

Dhe pikërisht për vrasje me dashje, më 13 tetor, pas pesë vjetëve nga ngjarja, Antonio Monella dënohet me 8 vjet burg.



Janë mbi 2.700 shqiptarë në burgjet e Italisë

Por thuajse gjysma e tyre janë në pritje të dënimit. Në burgjet italianë gjenden mbi 67 mijë vetë, rreth 22 mijë më shumë nga ç'është kapaciteti i tyre. 24.401 të huajt, kryesisht marokenë, rumunë, tunizinë, shqiptarë e nigerianë

Shifrat më të fundit të Dipartamentit të administratës së burgjeve, të përditësuara më 30 shtator të këtij viti dhe të dhëna sot në Senat nga ministri i Drejtësisë, Nitto Palma, thonë se mëse një e treta (36,10%) e të burgosurve në Itali janë të huaj. Ndër 24.401 të burgosurit e huaj, shqiptarët renditen të katërtit për nga numri, me 2.721 vetë, duke përfaqësuar 11% të të burgosurve të huaj. Më keq se komuniteti ynë, në këtë renditje të zezë, janë marokenët (me 4.934 të burgosur), rumunët (3.616 të burgosur), tunizianët (3.197). Përsa u përket llojit të krimeve për të cilat burgosen të huajt janë kryesisht vepra penale kundër pronës, shpërndarje droge droge, vepra penale kundër individit, mbajtje armësh dhe vepra penale kundër administratës publike.

Gjithsesi një e dhënë e rëndësishme që shpjegon edhe numrin e lartë të të huajve në burgje është ajo që ka të bëjë me shkallën e gjykimin: rreth gjysma e të burgosurve të huaj (12.035) janë në pritje të sentencës përfundimtare, madje 5.956 persona janë në pritje të shkallës së parë të gjykimin, dhe vetëm 12.147 janë duke vuajtur dënimin e dhënë me sentencë.

Shifrat e përgjithshme flasin për 67.428 të burgosur (italianë e të huaj, së bashku), 21.611 më shumë nga kapaciteti i përgjithshëm i 206 struktura të ndryshme të vuajtjes së dënimit në Itali. Të burgosurit në pritje të shkallës së parë të gjykimin janë 14.639 vetë, janë ende të pandehur (pra në pritje të sentencës përfundimtare) 28.564 vetë, të dënuar me sentencë përfundimtare vetëm 37.213 vetë dhe të internuar 1.572 vetë.

Nuk respektojnë sinjalin e "Ndal" Karabinieri qëllon e vret një 26 vjeçar

Ndjekja nga karabinierët e katër keqbërësve përfundoi me një të vrarë e dy të kapur. Viktima është Fatmir Xhafa 26 vjeç, të arrestuarit Altin Murrja, 22 vjeç dhe Lupen Allçiu 34 vjeç

Q uhet Fatmir Xhafa dhe ishte 26 vjeç, shqiptari i vrarë më 3 tetor në mëngjes nga një karabinier në postbllok në Caivano, komunë në veri të Napolit. Xhafa dhe tre shqiptarë të tjerë nuk ndaluan me dhënien e urdhrit "Ndal" nga karabinierët.

Ngjarja ka ndodhur në mëngjes në Caivano, komunë në veri të Napolit, kur dy karabinierë në shërbim për kontrollimin e territorit për parandalimin e vjedhjeve të shtëpive dhe të makinave, kanë vërejtur katër persona me sjellje të dyshimtë në një Opel Passat.

Sipas karabinierëve, u kanë dhënë urdhër të ndalojnë për t'i identifikuar, por katër personat në vend që të respektojnë urdhrin, kanë braktisur makinën dhe ia kanë mbathur në këmbë. Tre kanë përfunduar në një rrugicë pa krye ndërsa i katërti është përpjekur të marrë ar-

Vrau të riun shqiptar, sërish gjyq karabinierit

Do të hapet sërish gjyqi për vdekjen e shtetasit shqiptar Olsi Ferracaku, 21 vjeçari i vrarë më 8 maj të vitit 2009 nga një karabinier.

Ushtaraku, qëlloi me armë zjarri kundër automjetit Volkswagen "Bora" të drejtuar nga i riun shqiptar i cili nuk kishte respektuar sinjalin e ndalimit të dhënë nga karabinierët. Ky i fundit qëlloi duke e goditur për vdekje Olsi Ferracakun. Ndërhyrja e karabinierëve në zonë ishte rrjedhojë e sinjalizimit të një qytetari që kishte pësuar vjedhjen e banesës nga ana e katër keqbërësve.

Më 26 janar të këtij viti karabinieri ishte çliruar nga akuza për vrasje pa dashje të shkaktuar nga përdorimi i ligjshëm i armës. Gjykatësi për dëgjimin paraprak vendosi që "nuk duhet të vazhdohej sepse fakti nuk përbërë shkelje" duke shpjeguar se karabinieri nuk pati bërë vlerësime të gabuara dhe se vrasja e shqiptarit ishte një fatalitet. Një vendim ky që si prokuroria ashtu dhe të afërmit e viktimës patën kundërshtuar dhe tani ia arritën që procesi të rihapet.

ratinë fushave. Ky i fundit është kapur nga njëri prej karabinierëve që i ishte vënë pas, ndërsa tjetri që ndiqte tre të rrugicës ka hasur rezis-

tencën e tyre. Gjithnjë sipas versionit të karabinierëve, një nga tre të ndjekurit e ka goditur me shufër hekuri në parakrahun e djathtë dhe kjo

ka shkaktuar shkrehjen e pistoletës që karabinieri mbante në dorë, duke plagosur për vdekje njërin prej tre personave, 26 vjeçarin Xhafa.

Në përfundim të ndjekjes, dy karabinierët përveç të vrarit kanë kapur dy prej tre të mbeturve: Altin Murrja, 22 vjeç dhe Lupen Allçiu 34 vjeç. Të dy janë mbyllur në burgun Poggioreale të Napolit me akuzën e tentativës së vrasjes dhe fshehje mallrash të vjedhur.

Nga kontrollat e bëra më pas, karabinierët kanë zbuluar që Passat ishte e vjedhur muajin e shkuar në Avellino, që në makinë kishte një mijë euro, levë hekuri, maskë dhe doreza për të cilat të ndaluarit nuk dinin të jepnin shpjegime.

Nuk është herë e parë që ndjekja e disa shqiptarëve përfundon me vrasjen e njërit prej tyre. Në një rast shumë të ngjashëm me këtë të sotmin është vrarë më 9 maj 2009 edhe Olsi Ferracaku.

Sa kohë duhet të rri në Shqipëri nga një udhëtim Schengen në tjetrin?

Kur një person vjen nga Shqipëria me pasaportë biometrike mund të rrijë këtu 3 muaj. Kur kthehet në Shqipëri a ka ndonjë kufizim kohor? Sa duhet të qëndrojë atje para se të vijë prapë në Itali?

Sipas rregullave që disiplojnë liberalizimin e vizave, qytetarët shqiptarë me pasaportë biometrike mund të qëndrojnë në zonën Schengen maksimumi 90 ditë, që nga dita e hyrjes, gjatë një periudhe kohore prej gjashtë muajsh (180 ditë). Llogaritja e periudhës 90-ditore dhe gjashtë-mujore fillon që nga çasti kur personi hyn për herë të parë në këtë zonë.



Për shembull, nëse më datë 1 janar ju hyni për herë të parë në zonën Schengen, periudha e ardhshme gjashtë mujore fillon në datën 1 korrik. Kështu nga 1 janari deri më 30 qershor, ju mund të qëndroni në një shtet apo në disa shtete të zonës Schengen për maksimumi 90 ditë. Nga 1 korriku mund të nisni sërish udhëtimet duke pasur parasysh të bëni gjithnjë të njëjtat llogaritje.

Nëse udhëtoni shpesh në zonën Schengen, është përgjegjësia juaj të numëroni ditët e mbetura nga periudha gjashtë mujore.

Pra, ju mund të bëni disa udhëtime afatshkurtra, me kusht që kohëzgjatja e tyre, shuma e ditëve që qëndroni në zonën Schengen, të mos kalojë 90 ditët brenda periudhës gjashtëmujore (180 ditë) që nis nga udhëtimi i parë.

Punonjësi i varur, me rastin e martesës ka të drejtë për një leje të jashtëzakonshme që ndryshe quhet edhe leje martesë. Kjo e drejtë, është qoftë një ndër parimet e sanksionuara nga Kushtetuta italiane (neni 31 paragrafi 1) ashtu edhe e përcaktuar me ligj. Legjislacioni mbi mbi lejen e martesës daton në vitet 30-të (RDL 24 qershor 1937 nr. 1334). Dispozitat e mëtejshme për mënyrën se si të përfitohet nga kjo leje disiplinohen nga Kontratave kolektive kombëtare që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe nga qarkoret e INPS.

Kriteret

Kriteri kryesor për të mund të përfituar nga leja e martesës është vlefshmëria e martesës. Martesa duhet të njihet dhe të kenë vlefshmëri civile në Itali.

Nëse martesa është celebruar jashtë vendit, për të mund të përfituar nga kjo leje e jashtëzakonshme, është e nevojshme që personi të ketë vendbanimin në Itali. Për shembull punonjësi jo komunitar, ka të drejtë për këtë leje, me kusht që të jetë rezident në Itali, që përpara datës së martesës.

Për të mund të gëzuar këtë lloj lejeje, është e nevojshme t'i dorëzohet punëdhënësit certifikata e martesës. Nëse martesa është celebruar jashtë Italisë, punonjësi duhet t'i japë punëdhënësit certifikatë martesë të lëshuar nga autoritetet e huaja kompetente (të përkthyer dhe e legalizuar) dhe certifikatën e gjendjes civile të lëshuar nga komuna e rezidencës, certifikatë që vërteton se kërkuesi

është i martuar me personin e përmendur në certifikatën e martesës të lëshuar nga autoritetet e huaja.

INPS ka specifikuar se, në qoftë se shteti i përkatësisë së të huajit pranon poligaminë, mundësia për të përdorur lejen jepet vetëm për një martesë, përveç në rastet e shkurorëzimit apo vdekjes së bashkëshortit dhe një martesë të mëpasshme (INPS qarkore nr. 190 e vitit 1992). Shumica e kontratave kolektive kombëtare nuk parashikojnë leje martesë për punonjësit në periudhë prove.

Punonjësi duhet të paralojmë një punëdhënësin për leje për martesë nga 15 deri në 6 ditë përpara (periudha e njoftimit paraprak mund të jetë e ndryshme në varësi të Kontratës kolektive që rregullojnë marrëdhënien e punës). Punonjësi është i detyruar t'i paraqesë punëdhënësit, brenda 60 ditësh, certifikatën e martesës ose një certifikatë të përbërjes familjare, e cila vërteton kryerjen e martesës.

Desha të di se çfarë duhet të bërë kur merret një gjobë për shkelje të rregullave rrugore. Nëse gjoba konsiderohet e padrejtë, si mund të mbrohem?

Kur shkelet një normë e Kodit rrugor (dekrete legjislativ 285 i vitit 1992) forcat e rendit (Policia Bashkiake, Policia e Shtetit, Karabinierët, Policia Financiare apo individë të pajisur me një pushtet të posaçëm, p.sh. ndihmës të trafikut) verifikojnë shkeljen dhe përpilojnë një procesverbal. Komunikimi i shkeljes mund të jetë i menjëhershëm, (p.sh. për një parkim në vend të ndaluar) ose, kur nuk është e mundur (p.sh. për një kalim me semafor të kuq) komunikimi i shkeljes bëhet më pas, nëpërmjet dërgimit të procesverbalit në banesën e pronarit të makinës apo motorit.

Kujdes: gjoba duhet të njoftohet

zyrtarisht dhe të dorëzohet (notifica) brenda 90 ditëve nga data e shkeljes!

Kur njoftoheni për një shkelje e Kodit rrugor ka disa alternativa. Mund të paguani brenda 60 ditëve nga njoftimi i gjobës. Ose, nëse mendoni se gjoba është vënë padrejtësisht, mund t'i paraqitet ankesë Prefektit ose Gjyqtarit të Paqes.

Çfarë ndodh nëse nuk paguani

Nëse vendosni të mos paguani, është mirë të dini se 60 ditë pas njoftimit, gjoba do të dyfishohet. Përveç kësaj, gjoba nuk do të mund të kundërshtohet më dhe procesverbalit do t'i dërgohet një entit të emëruar nga

GJOBAT

Komuna për mbledhjen e borxheve. Ky i fundit do të dërgojë një "kartelë pagese", në të cilën shumë të dyfishuar të gjobës do t'i ngarkohen kundërvajtësit shpenzimet shtesë, interesat dhe shpenzimet e shërbimit. E njëjta gjë ndodh edhe kur gjoba paguhet me vonesë, pas afatit 60 ditor nga data e njoftimit.

Si dhe kur paguhet

Nëse vendosni të paguani, është

mirë që ta bëni brenda afateve të parashikuara nga ligji, (pra brenda 60 ditëve mbërritja e letres së porositur me procesverbalin e shkeljes). Siç thuhet dhe më lart, nëse pagesa bëhet pas 60 ditësh, shuma automatikisht dyfishohet dhe Komuna ia dorëzon gjobën entit përkatës për grumbullimin e kredive.

Pagesa mund të bëhet në zyrat postare dhe në disa pika shitjeje të duhanit.

Pas pagimit, është mirë të ruani për



ISI RICERCA HOSTESS E PROMOTER INTUTTA ITALIA.

I candidati si occuperanno della promozione e vendita dei servizi ISI direttamente nel punto vendita. Si richiede precedente esperienza in attività di vendita, e disponibilità immediata a lavorare sia part time che full time, che nel fine settimana. Completano il profilo dinamicità, flessibilità e forte predisposizione alla vendita nonché massima serietà e disponibilità.

Se interessati mandare curriculum con foto a: e-mail: customerservice@isi.eu.com oppure telefonare orario ufficio ai numeri 06 87410555 - 06 87410412

AGENZIA DI CONSULENZA E SERVIZI EJONA



Ejona, è l'agenzia di consulenza, nata a Milano, con la missione di facilitare e accompagnare nella strada dell'integrazione, con professionalità e umanità i propri clienti, studenti e cittadini albanesi, residenti in Italia nel disbrigo delle pratiche burocratiche e questioni legali. Inoltre, anni di conoscenza del territorio e di quel che offre la regione Lombardia, consentono di offrire le soluzioni migliori a tutti i connazionali che vorranno viaggiare in Italia, per affari, turismo, eventi, shopping ecc.

Web: www.ejona.eu - Email: info@ejona.eu

Tel: +39 388 6908991 - Skype: [ejona.milano](https://www.skype.com/name/EjonaMilano) - Facebook: [Ejona Milano](https://www.facebook.com/EjonaMilano)

Leje nga puna për martesë

Së shpejti do të martohem, dhe desha të di nëse kam të drejtë të marr disa ditë pushimi për martesën. Punoj me dokumente të rregullta nga viti 2009, po me të njëjtin punëdhënës. Çfarë duhet të bëj?

Sa zgjat leja nga puna për martesë

Leja e martesës parashikon një periudhë mungese nga puna të paguar e me kohëzgjatje prej 15 ditësh (por kontratat kolektive kombëtare mund të parashikojnë periudha të ndryshme). Gjatë periudhës së kësaj lejeje, punonjësi ka të drejtën e një shpërblimi normal që në shumicën e rasteve është në ngarkim vetëm të punëdhënësit (në disa raste, si në atë të punëtorëve shtëpiake, Kontrata kolektive kombëtare parashikon që shpërblimi për periudhën e lejes të merret kur paraqitet dokumentacioni që vërteton kryerjen e martesës). Në qoftë se punonjësi i përket kategorive të punonjësve të ndërmarrjeve industriale, të artizanëve dhe kooperativave, një pjesë e pagës jepet



INPS ka specifikuar se, në qoftë se shteti i përkatësisë së të huajit pranon poligaminë, mundësia për të përdorur lejen jepet vetëm për një martesë, përveç rasteve të shkurorëzimit apo vdekjes së bashkëshortit dhe një martese të mëpasshme

nga punëdhënësi dhe një tjetër nga INPS-i. Leja duhet të kërkohej dhe të shfrytëzohet brenda 30 ditëve nga data e martesës, me përjashtim të rasteve kur paraqiten rrethana të paparashikueshme ose nevoja të veçanta të punëdhënësit. Leja e martesës është një leje e jashtëzakonshme, dhe si e tillë nuk mund të përko-



jë me lejen e zakonshme, as me periudhën e mundshme të paralajmërimit për pushim nga puna. Në rast se ajo përkon me lejen e zakonshme, punonjësi do t'i ruajë ditët e lejes së zakonshme dhe do të mund t'i shfrytëzojë në një periudhë të mëvonshme.

Çeku për lejen e martesës

Për disa kategori punonjësish një pjesë e shpërblimit për periudhën e lejes së martesës, jepet drejtpërdrejt nga INPS, nëpërmjet një çeku, pas paraqitjes së kërkesës për leje

nga puna për martesë brenda një viti nga martesja dhe pas paraqitjes së certifikatës së martesës. Është fjala për disa kategori të veçanta punonjësish mes të cilëve përfshihen punëtorët, praktikantët, punonjësit që ofrojnë shërbimin e tyre në shtëpi (të cilët nuk janë bashkëpunëtorë familjarë, të ashtuquajtur colf ose badanti), punëtorët që me gjithë ekzistencën e marrëdhënies së punës, për ndonjë arsye të justifikuar nuk janë në punë (sëmundje, pezullim i përkohshëm nga puna).

I takon ky çek edhe punëtorëve të papunë të cilët janë në gjendje të dëshmojnë se në periudhën 90 ditore përpara datës së martesës, kanë punuar për të paktën 15 ditë pranë një punëdhënësi.

Pagesa nuk i takon të punësuarve të industrisë, artizanëve, kooperativave, dhe të përpunimit të duhanit me kualifikimin e nëpunësit, praktikantit ose të drejtuesit. Ashtu siç nuk i takon punonjësve të bujqësisë, të tregtisë, të fushës së kredive, të sigurimeve.

Mënyra e paraqitjes së kërkesës është e shpjeguar në faqen internet të INPS (www.inps.it).

Avokat Andrea De Rossi

Ku t'i paguajmë dhe si të mbrohemi kur janë të padrejta

të paktën pesë vjet kuponin e pagesës. Kjo sepse ndonjëherë për gabime të administratës, pagesa nuk rezulton dhe si rrjedhojë fillon procedura për mbylljen e borxhit edhe pse pagesa është kryer.

Duke ruajtur kuponin e pagesës, mund të dëshmohej, nëse ju mbërrin kartela e pagesës, nga enti i caktuar për mbledhjen e kredive, se gjoba është paguar në kohë.

Nëse gjoba konsiderohet e padrejtë

Kur gjobën e konsideroni të padrejtë, mund të zgjidhni dy rrugë. Ankesa tek Prefekti ose tek Gjyqtari i Paqes. Të dy opsionet janë alternative, që do të thotë se nëse paraqitet ankesë pranë Prefektit nuk mund të paraqitet edhe pranë Gjyqtarit të Paqes dhe anasjelltas. Në të dyja rastet, afati për paraqitjen e ankesës është 60 ditë pas njoftimit të gjobës.

Ankimimi tek Prefekti

Ankesa duhet të dorëzohet në zyrat e Prefekturës së vendit ku është kryer shkelja. Ajo gjithashtu mund të paraqitet në zyrën ose komandën përkatëse të organit që ka bërë procesverbalin e shkeljes ligjore, ose mund t'i dërgohet kjo ankesë me letër

të porositur me firmë kthimi.

Në ankesë duhet të jepen të gjitha detajet e dënimit administrative (numri procesverbalit, vendi dhe data e shkeljes) dhe duhet të specifikohen arsyet për të cilat gjoba konsiderohet e padrejtë.

Arsyet e ankesës mund të jenë formale (për shembull, kur procesverbalit u është dorëzuar dhe njoftuar pas afatit të parashikuar nga ligji, ose kur në procesverbal nuk janë përmendur rregullat e shkelur) ose arsyet mund të kenë lidhjet me arsyen e shkeljes (për shembull, nëse keni qenë të detyruar të kryeni shkeljen- të mendojnë për një defekt të makinës dhe që ju detyron ta parkoni atë përkohësisht në një vend të ndaluar apo në rastin e një gjobe për shpejtësi të tepruar, të shkaktuar nga një emergjencë siç mund të jetë nevoja për të shkuar në spital).

Është mirë që ankesës t'i bashkëngjiten të gjitha dokumentet e nevojshme për të sqaruar faktet dhe për të kundërshtuar dënimin e lartë. Gjithashtu mund të kërkontë që të dëgjoheni nga Autoriteti përkatës.

Nëse jeni të kërkohej që të dëgjoheni, vendoset një datë e cila më pas i komunikohet ankuesit. Në këtë datë është i thirrur pranë zyrave e Prefekturës për sqaruar çështjen e tij.

Prefekti, pasi ka marrë ankesën dhe të gjithë dokumentet nga organet që

kanë hartuar procesverbalin e shkeljes ligjore, ka maksimumi 120 ditë kohë për të vendosur nëse do ta pranojë apo do të hedhë poshtë atë. Në rast se ekziston kërkesa për t'u dëgjuar, kjo ndërpret afatin, i cili mbetet pezull deri datën kur është vendosur të bëhet seanca e dëgjimit. Pasi të jetë marrë vendimi, ka 150 ditë të tjera për t'ia komunikuar atë personit të interesuar.

Në rast se nuk ka përgjigje brenda kësaj periudhe, ankesa do të konsiderohet e pranuar.

Ndërsa kur Prefekti vendos të hedhë poshtë arsyet e ankesës, ai lëshon një urdhër të prerë me të cilin kërkon pagesën e dyfishit të gjobës administrative të kundërshtuar. Kundër këtij urdhri të prerë mund të bëhet gjithsesi ankesë tek Gjykatësi i Paqes brenda 30 ditëve nga njoftimi.

Ankesa pranë Prefektit është e përjashtuar nga taksat. Nëse vendosni ta paraqesë nëpërmjet letrës së porositur, kostoja do të jetë vetëm ajo e dërgimit. Rekomandohet që ankesa të mos dërgohet në zarf, por me pako të porositur.

Ankesa tek Gjyqtari i Paqes

Ankesa të Gjyqtari i Paqes është një alternativë e ankesës tek Prefekti; edhe në këtë rast afati për paraqitjen

është 30 ditë pas marrjes së njoftimit për procesverbalin e shkeljes (Nga 6 tetori ka hyrë në fuqi ligji që ka ulur kohën e paraqitjes së ankimit përpara gjykatësit të paqes nga 60 në 30 ditë).

Ky është një gjykim i vërtetë. Me paraqitjen e ankesës, emërohet një gjyqtar që do të gjykojë mbi arsyet e ankesës. Në gjykimin kundër sanksioneve administrative, pala që ka paraqitur ankesën mund të paraqitet në seancë pa ndihmën e një avokati, por kujdes: në rast se ankesa është përgatitur personalisht, është thelbësore paraqitja në seancë, përndryshe ankesa hidhet poshtë.

Ankesa duhet të shoqërohet nga origjinali i procesverbalit të kundërshtuar (është e mirë pra të bëni kopje për t'i mbajtur) dhe nga dokumentet që keni interes për të bashkëngjitur.

Ankesa, me dokumentet mbështetëse të bashkëngjitura, duhet të depozitohet drejtpërdrejt në zyrat e Gjyqtarit të Paqes, ose mund të dërgohet me postë rekomandë me firmë kthimi (origjinalit të ankesës i duhen bashkëngjitur edhe 5 kopje).

Ankesa pranë Gjyqtarit të Paqes për të kundërshtuar një gjobë ka kosto. Për gjobat deri në 1.000 € duhet paguar një "kontribut i unifikuar" prej 45 euro pranë pikave të shitjes së duhanit të pajisura me sistem pagese. Për gjoba mbi të larta, kontributi i

unifikuar rritet në vlerë. Përveç kësaj, duhet të blini edhe një pullë takse prej 8,00 €.

Pasi të emërohet Gjyqtari, do të caktohet një datë kur do të mbahet seanca. Gjatë seancës do të diskutohen shkaqet e ankimit dhe Gjyqtari do të shqyrtojë të gjitha dokumentet e bashkëngjitura ku mbështetet ankimi. Për të dëgjuar dëshmitarët dhe për të vlerësuar provat e tjera të mundshme, gjyqtari mund të caktojë seanca të mëtejshme.

Pas dëgjimit të ankuesit (ose avokati i tij) dhe pas vlerësimit të provave të sjella në mbështetje të ankesës, Gjykatësi do të japë vendimin. Vendimi i Gjykatësit mund të jetë pranimit ose hedhja poshtë e ankesës.

Në rast të refuzimit, kundër vendimit të Gjyqtarit të Paqes mund të bëhet ankim në gjykatë dhe në këtë rast është e detyrueshme asistencë e një avokati.

Së fundi, duhet të mbahet mend se gjatë periudhës nga 1 gusht-15 shtator afati për të paraqitur ankesë prapë Gjyqtarit të Paqes është i pezulluar, pra ndërpriten në fillim të gushtit dhe rifillojnë sërish nga 15 shtatori. Kështu, për shembull, nëse gjoba është njoftuar më 3 gusht, 30 ditët e afatit për t'u ankuar, fillojnë nga 16 shtatori e tutje.

Avv. Andrea De Rossi



A Torino con
un guasto
all'auto

**TRASFERIMENTO VELOCE
DI DENARO IN ITALIA A PARTIRE
DA**
€ 4.90

Riprendi il viaggio
verso Firenze

Sorprendi i tuoi cari su
www.4-90forbetter.it



**Regala momenti di gioia ai tuoi amici ed alla tua famiglia su
4-90forbetter.it ed otterrai un grande impatto con un piccolo gesto**

Offerta valida dal 22.11.2010 per i Paesi zona EURO.

• **Trasferimento di denaro** •

**WESTERN
UNION**

moving money for better

Il denaro è generalmente disponibile in minus contabilmente al termine e condizioni del servizio, inclusi gli oneri di apertura dei punti vendita degli Agenti e le differenze di fuso orario. Prendere visione del modulo To Send per le condizioni del servizio.